



# Mbrojtja

Viti i 89-të i botimit  
Mars 2021/ Nr. 3



**Ministeriali i NATO-s në Bruksel**  
**Zv/ministri Koçi:**  
**Shqipëria do të investojë**  
**në modernizimin e FA-së**



**Takimi Begaj-Jarrard**  
**Stërvitja "Defender**  
**Europe 21" zhvillohet nga**  
**data 1 maj-14 qershor 2021**



**Ushtarakja shqiptare në KFOR**  
**Eksperiencë unike**  
**në strukturë**  
**dhe ekspertizë**



**NË BAZËN AJRORE TË FARKËS**  
**Filloi Kursi Bazë i Oficerit në**  
**specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri**

# Përmbajtja

Numri 3

## MINISTERIALI I NATO-S NË BRUKSEL

- 6** Zv/ministri Koçi: Shqipëria do të investojë në modernizimin e FA-së

## STËRVITJA "DEFENDER EUROPE 21"

- 11** Atasheu ushtarak i SHBA-së, James Hilton viziton Forcat Detare

## URIMI

- 22** "Për ju koleget e mia që shërbeni në Forcat e Armatosura"

## PANDEMIA

- 35** Mësimdhënia online në Qendrën e Gjuhëve të Huaja të AFA-së

## BOTIME USHTARAKE

- 40** Libri "Oficerët e xhenios në rrjedhën e historisë"

## STAFI

### DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

### Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA  
Hajrie DEDAJ

### Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ

### Redaktore/ korrektore:

Suela HODA



## 4 NË BAZËN AJRORE TË FARKËS

### Filloi Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri

Një pjesë e pilotëve të ardhshëm ushtarakë të helikopterëve të Forcës Ajrore shqiptare do të formohen brenda vendit. Në Bazën Ajrore të Farkës u çel Kursi...



## 13 MODERNIZIMI I FA

### Ushtria Amerikane dhuron 29 mjete "Humvee" për Forcat e Armatosura

Ushtria e SHBA-së i ka dhuruar Forcave të Armatosura të Shqipërisë 29 automjete, të njohura si "Humvee". Lajmin e ka bërë me dije Ambasada...



## 31 USHTARAKJA SHQIPTARE NË KFOR

### Eksperiencë unike në strukturë dhe ekspertizë

Kolonele Vehbije Kuti, aktualisht me detyrë përgjegjëse sektori & z/drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura...



## 37 DR, ANTIÇ, DR, QARAGE DHE DR, ÇAFTANATOV

### NATO mbështet gratë dhe vajzat në shkencë

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave dhe Vajzave në Shkencë, po sjellim tre gra të reja, se si ato po bëjnë përparime të mëdha në teknologji dhe inovacion...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



# Mbrojtja



## REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror  
i Ministrisë së Mbrojtjes  
Viti i 89-të i botimit  
Nr. 3/2021

### © Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë  
revistë nuk mund të riprodhohen  
elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfutimi, pa  
marrë autorizim nga botuesit e saj.

### Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,  
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe  
Botimeve të Mbrojtjes

### Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/  
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





# NË BAZËN AJRORE TË FARKËS

## Filloi Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri

**N**jë pjesë e pilotëve të ardhshëm ushtarakë të helikopterëve të Forcës Ajrore shqiptare do të formohen brenda vendit. Në Bazën Ajrore të Farkës u çel Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri, i cili do të ndiqet nga nëntogerë të përzgjedhur nga forca dhe reparte të ndryshme të Forcave të Armatosura.

Në nisjen e këtij kursi, më 2 mars 2021, ishte i pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili shoqërohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj. Ministri Peleshi e konsideroi nisjen e Kursit të Pilotit si një ngjarje të shënuar, jo vetëm për Forcën Ajrore, por dhe për gjithë Forcat e Armatosura në përgjithësi dhe i siguroi kadetët për mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Mbrojtjes.

“Sot ju do të filloni hapin e parë për t’u bërë pjesë e gjeneratës së pilotëve, të cilët jo vetëm e kanë dashuruar profesionin e tyre, por vazhdimisht kanë kryer me sukses dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara. Në rrugëtimin që po nisni sot për t’u përgatitur si pilotë të ardhshëm ju do të keni kurdoherë mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Unë jam besimplotë se Forca jonë Ajrore do të zhvillohet e modernizohet me ritme të shpejta, do të ketë një vëmendje të veçantë dhe të merituar. Modernizmi teknik i bashkuar, i kombinuar me pasionin dhe përkushtimin e vajzave dhe djemve kështu si jeni ju, janë siguria jonë për të pasur një Forcë Ajrore dinjitoze dhe të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave

*Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak*

*Helikopteri zgjat 49 javë mësimore-praktike dhe ndahet në dy faza: përgatitja Speciale-Helikopteri dhe Praktika Profesionale.*

*Pjesë e kursit janë 12 kadetë, mes të cilëve edhe një vajzë.*



të kohës dhe nevojave të vendit. Do mundësojmë që ato orë fluturimi të domosdoshme për t'u quajtur pilot, ju t'i plotësoni dhe të jeni me të vërtetë gjenerata e re e pilotëve dinjitozë e një Force Ajrore që sa më shumë kalon koha, po modernizohet dhe do të modernizohet.” - u shpreh ministri Peleshi, i cili përshëndeti në mënyrë të veçantë të vetmen vajzë pjesëmarrëse në këtë kurs.

“Do të dëshiroja të përfundoja urimin tim për ju duke e mbyllur në mënyrë të veçantë me Armelën që është një vajzë që do të përgatitet për të qenë pilotja e parë në FA.” Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Pilot Ushtarak Helikopteri zgjat 49 javë mësimore-praktike dhe ndahet në dy faza: përgatitja Speciale-Helikopteri dhe Praktika Profesionale.

Pjesë e kursit janë 12 kadetë, mes të cilëve edhe një vajzë.



MINISTRI I MBROJTJES, NIKO PELESHI

# FA do të angazhohen për vaksinimin masiv të popullsisë

*Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kanë qendra që mund të hapen në çdo qytet me mjekë, infermierë, automjetete dhe çdo mjet logjistik për tu vendosur në dispozicion*

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi duke folur nga Korça, vlerësoi punën për personelin mjekësor në vijën e parë të betejës me armikun e padukshëm, ndërsa shtoi se nuk do të ketë nevojë për masa më të forta, nëse do t'i mbajmë numrat nën kontroll. “Me personelin mjekësor është në vijën e parë të betejës me këtë armik të padukshëm. Kam një falënderim të veçantë për të gjithë mjekët dhe infermierët që janë në ndihmë të të sëmurëve me Covid-19. Mërzitemi kur dëgjojmë për humbje jete, ndaj sot është zgjidhja përfundimtare. Jemi në një moment jo të mirë të numrave me shifra maksimale, ndaj secili nga ne duhet të jetë i përgjegjshëm për të ruajtur veten dhe të tjerët dhe e gjithë situata se si do të shkojë sëmundshëmria varet nga të gjithë ne. Në rast se ne do t'i mbajmë numrat nën kontroll pa shkakuar kolapsimin e spitaleve sigurisht që nuk ka nevojë për masa më të forta. Në rast se numrat do vijojnë të rriten, normalisht që do të ketë shtrëngim të masave. E ardhmja e vaksinimit është optimiste, këtu në Korçë ka nisur për të përfunduar me të gjithë personelin mjekësor dhe më pas do vijohet me moshat mbi 80 vjeç. Kemi sinjale shumë të mira siç e ka thënë edhe KM se Shqipëria do të jetë e para në rajon që do të nisë vaksinimin masiv për të gjithë popullatën dhe besoj se në ditët në vazhdim do të kemi lajme shumë të mira”, -tha Peleshi.

Nga ana tjetër, Ministria e Mbrojtjes dhe FA janë të angazhuara plotësisht për të asistuar në procesin e vaksinimit. “FA do të jenë në dispozicion të procesit për vaksinimin intensive”.

Ministri Peleshi tha se: “Mjekët dhe infermierët në uniformë, përfshirë logjistikën e Forcave të Armatosura do të angazhohen për vaksinimin masiv të popullsisë kundër COVID-19”.

“Kemi sinjale shumë të forta, siç e ka përcjellë edhe kryeministri, që Shqipëria do të jetë një nga vendet e para në rajon, shpresoj, që do t'a sigurojë vaksinimin masiv, që do të sigurojë vaksina për të gjithë popullsinë. Kjo na vë në pozitë, kur them ne, të gjitha institucionet që kanë mundësi të japin një dorë në procesin e vaksinimit dhe këtu po flas tani për Forcat e Armatosura, për Ministrinë e Mbrojtjes, na vendos në përgjegjësinë dhe nevojën për të angazhuar të gjitha burimet tona. Forcat e Armatosura do të jenë në funksion të vaksinimit intensiv, masiv. Ne kemi brenda strukturës sonë rreth 100 infermierë, por kemi shumë logjistikë, kemi shumë qendra që mund t'i hapim në çdo bashki, në çdo qytezë, apo fshatra të mëdha në rast se do të gjykohej të ngrihet një sistem i tillë, kemi personel mjekësor, jo vetëm infermierë, edhe mjekë, kemi mjete transporti, kemi shumë logjistikë që do të jetë e gjitha në funksion të vaksinimit intensiv.” - deklaroi ministri Peleshi.



# Ministeriali i NATO-s në Bruksel, 17-18 shkurt 2021

## Zv/ministri Koçi: Shqipëria do të investojë në modernizimin e FA-së

U konfirmua angazhimi aktual i Forcave të Armatosura në Kosovë dhe Letoni, si dhe kontributi në Afganistan në përputhje me vendimarrjen kolektive të Aleancës sipas parimit "In together-out together"

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s u takuan virtualisht nëpërmjet telekonferencës së sigurtë, më datë 17-18 shkurt 2021, për të adresuar disa çështje kyçe të sigurisë: përshtatjen e Aleancës nëpërmjet iniciativës "NATO-2030", progresin drejt ndarjes së drejtë të barrës "fair burden-sharing", Shkurajimin dhe Mbrojtjen "Defence and Deterrence" e përforcuar të NATO-s, operacionet dhe misionet e NATO-s në Afganistan dhe Irak, etj.

Ministeriali u zhvillua sipas programit me dy sesione formale vetëm me vendet e NATO-s dhe një sesion i veçantë me vendet partnere të NATO-s, ku morën pjesë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, ministrat e Mbrojtjes së Finlandës, Suedisë, përfaqësuesi i Bashkimit Europian për Punët e Jashtme dhe Sigurinë dhe zëvendës-presidentii Komisionit Europian z. Josep Borrell.

Për shkak të infektimit nga Covid-19, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi nuk mund të merrte pjesë në këtë takim dhe u përfaqësua nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi. Në fjalën e tij, z. Koçi përshëndeti Raportin NATO 2030 dhe e konsideroi atë si një bazë e fortë për diskutime të mëtejshme. Ai theksoi rëndësinë e madhe të parimeve kryesore të unitetit, solidaritetit dhe kohezionit ndërmjet vendeve anëtare të Aleancës si dhe rëndësinë e lidhjes transatlantike. Për Raportin NATO 2030, z. Koçi vlerësoi gjetjet dhe rekomandi-

met dhe siguroi vendet anëtare se Shqipëria do të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve dhe përballjen me sfidat që e presin Aleancën. Për sa i përket Zotimit për Investime në Mbrojtje (DIP), z. Koçi siguroi se Shqipëria do të mbajë këtë zotim dhe se është në rrugë të mbarë për implementimin e tij, pavarësisht impaktit financiar të krijuar nga tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia Covid-19. Ndërsa, për kontributet në operacione dhe misione të NATO-s, Z. Koçi pasi vlerësoi kontributin e trupave ushtarake në operacione dhe misione dhe aktivitete të NATO-s në këtë kohë pandemie, konfirmoi ruajtjen e angazhimeve aktuale të Shqipërisë në Kosovë dhe Letoni, si dhe vijimin e kontributit shqiptar në Afganistan në përputhje me vendimarrjen kolektive të Aleancës sipas parimit "In together – out together".

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg theksoi se ky takim është një moment i rëndësishëm dhe bazë për përgatitjet për samitin e krerëve të shteteve të Aleancës në fund të këtij viti.

Z. Stoltenberg në fjalën e tij përmendi punën e bërë në hartimin e dokumentit "NATO 2030", që do të shërbejë si bazë për hartimin e Konceptit të ri Strategjik të Aleancës. NATO 2030 ka për qëllim të bëjë Aleancën transatlantike më të përshatshme për të ardhmen nëpërmjet disa propozimeve ambicioze për përgatitjen e samitit të ardhshëm të krerëve të vendeve të NATO-s, ku ndër të tjera përmendim: rritjen e angazhimit për shkurajimin dhe mbrojtjen, duke inkurajuar Aleatët për të ofruar më shumë kapacitete duke ruajtur parimin e ndarjes së drejtë të barrës; rritjen e nivelit të ambicies për rimëkëmbjen (resilience), e cila është vija e parë e mbrojtjes; promovimi i bashkëpunimit transatlantik për inovacionin në fushën e mbrojtjes duke ruajtur nivelet më të larta të teknologjisë; përmirësimin e aftësive trajnuese dhe ngritja e kapaciteteve në vendet partnere të NATO-s; përditësimi i Konceptit Strategjik të NATO-s; etj.

Ky ishte Ministeriali i parë i Mbrojtjes me administratën e re të presidentit Biden dhe u vlerësua për hapjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet midis Europës dhe Amerikës së Veriut.







Gjeneralmajor Bajram Begaj takon gjeneralmajor Joseph Jarrard

# Stërvitja “Defender Europe 21” zhvillohet nga data 1 maj-14 qershor 2021

**Paketa e stërvitjes drejtohet nga Komanda e Forcave Tokësore Amerikane (US ARMY EUR) dhe përbëhet nga katër stërvitje kryesore të ushtrisë së SHBA, të cilat do të zhvillohen njëkohësisht të bashkërenduara me njëra-tjetrën dhe me stërvitje të tjera të NATO-s**

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti më 3 shkurt 2021, në takim pune Gjeneral Major Joseph Jarrard, zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Forcave Tokësore Amerikane në Evropë dhe Afrikë, në kuadër të zhvillimit në vendin tonë të stërvitjes “Defender Europe 21” e cila që nga viti 1995, konsiderohet si një nga më të mëdhatë në Europë.

“Defender Europe 21”, e cila do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021, është stërvitja shumëkombëshe më e madhe, e zhvilluar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rajonin tonë, në tre dekadat e fun-

dit, si për forcat pjesëmarrëse dhe mjetet e dislokuara, ashtu dhe për forcat dhe mjetet që do të kryejnë kalimin transit në vendin tonë.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të demonstrojnë kapacitetet e vendit pritës, koordinuese dhe mbështetëse, të një stërvitje në shkallë të gjerë dhe komplekse, si dhe trajnimi për të gjithë komponentët dhe shërbimet, në stërvitje të përbashkëta dhe rajone të ndryshme.

Përmirësimi e ndërveprueshmërisë dhe rritja e besueshmërisë së aleatëve tek kapacitetet, përgatitja dhe procedurat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të operuar së bashku me forcat e vendeve të

tjera të NATO s apo edhe midis forcave të ndryshme janë objektivat tonë operacional, shprehu gjeneralmajor prof. asoc. Begaj. Më tej ai theksoi se “Forcat tona janë të mirëstërvitura dhe të pajisura me armatim dhe mjete bashkëkohore, për të ndërvepruar krah për krah me forcat ushtarake amerikane dhe vendeve të tjera aleate”.

Ndërsa, gjeneralmajor Jarrard vlerësoi partneritetin dhe bashkëpunimin ushtarak me FARSH-in, dhe falënderoi SHSHP të FA për mbështetjen e dhënë për zhvillimin me sukses të kësaj stërvitje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Stërvitja do të shërbejë si platformë për përgatitjen dhe cer-



tifikimin e kapaciteteve operative (reparteve) të deklaruara në NATO, në kuadër të një operacioni shkrajues për përbashkimin e një rreziku/kundërshtari të përbashkët. Risi e kësaj stërvitje do të jetë përfshirja e Qendrës së Kontroll Raportimit të Forcës Ajrore në Sistemin e Komandim Kontrollit të operacioneve ajrore. Paketa e stërvitjes drejtohet nga Komanda e Forcave Tokësore Amerikane (US ARMY EUR) dhe përbëhet nga katër stërvitje kryesore të ushtrisë së SHBA, të cilat do të zhvillohen njëkohësisht të bashkërenduara me njëra - tjetrën dhe me stërvitje të tjera të NATO.

SHSHP i FA gjithashtu vuri theksin te sfida e zhvillimit të stërvitjes gjatë situatës së pandemisë globale, e cila do të dëshmojë se ne jemi në gjendje të ruajmë gatishmërinë operative dhe përmbushim misionin tonë kushtetues edhe në këto situata. Ai siguroi bashkëfolësin për zbatimin e protokolleve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së virusit "COVID 19", kujdesi shëndetësor ndaj personelit pjesëmarrës në stërvitje, si edhe popullsisë në rajonet stërvitore është dhe do të jetë prioritet.

Gjatë vizitës dyditore në Tiranë, gjeneralmajor Jarrard pati takime me autoritet më të larta të komandimit dhe drejtimit të FA, si dhe me disa autoritete të institucioneve kryesore të sigurisë së

vendit dhe të politikës.

\*\*\*

Gjeneral Majori Joseph Jarrard është me prejardhje nga Dahlonaga, Georgia-SHBA. Ai mori detyrat e tij si zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Forcave Tokësore Amerikane në Evropë dhe Afrikë, më 1 Prill 2019. Gjeneral Majori Jarrard u diplomua nga Kolegji North Georgia-SHBA në vitin 1988. I emëruar nga guvernatori i Shtetit

Gjeorgjisë u zgjodh nga Komanda e Forcave të Ushtrisë Amerikane për të drejtuar rrugën në zbatimin e Programit të Njësisë së Asociuar të Ushtrisë. Skuadra luftarake e Brigadës së 48-të të Këmbësorisë të Georgia është në linjë direkt me Divizionin e 3-të të Këmbësorisë. Ai ka qënë në Irak në mbështetje të Operacionit Irak-Liria" në vitet 2003 dhe 2005. Ai gjithashtu punoi si kontraktor i mbrojtjes në



të Gjeorgjisë në 2014, Gjeneral Majori Jarrard shërbeu si Adjutant i Përgjithshëm i 42-të i Georgisë. Më parë ai shërbeu tre vjet si ndihmës gjeneral dhe gjeneral komandues i Gardës Kombëtare të Ushtrisë Georgia. Nën drejtimin e tij, Garda Kombëtare e Ushtrisë së

Afganistan nga muaji prill 2010 deri në shtator 2011. Çmimet dhe dekoratat e tij përfshijnë "Legjioni i Meritës", "Yllin e Bronzit", medalja "Shërbimi Meritor", etj. Gjeneral Majori Jarrard është i martuar me Susan, dhe kanë tre djem, Ben, Will dhe Joseph.



# Gjeneralmajor Begaj në seminarin e nivelit të lartë të OSBE

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në seminarin 2 ditor të nivelit të lartë mbi doktrinën ushtarake të organizuar nga Forumi për Siguri dhe Bashkëpunim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), forum i cili aktualisht është nën kryesimin e SHBA.

Në seminar u trajtuan çështje që lidhen me situatën e sigurisë në zonën evropiane dhe vlerësimin e trendeve operacionale, shkurajimin nëpërmjet forcës konvencionale, garën strategjike brenda kufirit të konfliktit të armatosur, bashkëpunimin midis shteteve, si dhe rolin e forcave të armatosura në përgjigje ndaj krizave duke analizuar edhe impaktin e pandemisë në zhvillimin e doktrinës ushtarake.

Në fjalën e tij gjatë seminarit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj nënvizoi faktin se edhe pse ka një trend pozitiv në zonën evropiane si integrimi, bashkëpunimi dhe përpjekjet e përbashkëta për paqe, liri, siguri dhe drejtësi, përsëri situata e sigurisë aktuale përballat me sfida dhe kërcënime që tejkalojnë natyrën tradicionale dhe kërkojnë një bashkëpunim ndërkombëtar.

Pandemia e COVID-19 ka sjellë një tjetër dimension në mënyrën se si Forcat e Armatosura do të përballen me sfidat dhe rreziqet ndaj sigurisë.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj konfirmoi se OSBE mbetet një platformë kyçe për nxitjen e dialogut, transparencës dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve, duke kontribuar kështu në sigurinë e rajonit.

Në përfundim, pjesëmarrësit



Për vitin 2021 seminari u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformës online në kuadër të zbatimit të masave ndaj pandemisë COVID-19 duke sjellë së bashku rreth 350 ushtarakë dhe ekspertë të nivelit të lartë

në seminar ranë dakord që takime të tilla të nivelit të lartë i shërbejnë rritjes së bashkëpunimit midis shteteve dhe duhet të intensifikohen në të ardhmen.

Ky aktivitet zhvillohet një herë në pesë vjet dhe ka për qëllim kryesor nxitjen e dialogut dhe shkëmbimin e informacioni midis përfaqësuesve më të lartë ushtarakë të shteteve, duke synuar arritjen e një kuptimi të

përbashkët doktrinar mbi sigurinë evropiane si dhe ndërtimin e mirëbesimit të ndërsjellët dhe transparencës së aktiviteteve ushtarake të shteteve. Për vitin 2021 seminari u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformës online në kuadër të zbatimit të masave ndaj pandemisë COVID-19 duke sjellë së bashku rreth 350 ushtarakë dhe ekspertë të nivelit të lartë.



**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në 1 mars 2021, në video-konferencën mbi Komunikimin Strategjik, në kuadër të përgatitjes për stërvitjen "Defender 21", konferencë e organizuar nën drejtimin e Komandës së Forcave Tokësore Amerikane për Europën dhe Afrikën. Në konferencë morën pjesë personel i nivelit të lartë ushtarak i Komandës së SHBA-së në Europë, strukturave të NATO-s, si dhe vendeve anëtare dhe partnere pjesëmarrëse në stërvitjen Defender 21, ku u trajtuan çështje që lidhen me kontekstin strategjik që përshkon stërvitjen, planin e komunikimit gjatë elementëve të stërvitjes, si dhe strategjinë për menaxhimin e keqinformimit të mundshëm. Në fjalën e tij gjatë konferencës, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj theksoi se stërvitja "Defender 21" do të jetë një platformë ideale jo vetëm për të testuar kapacitetet ushtarake të vendit tonë, por gjithashtu do të mbartë një mesazh të qartë të mbështetjes së aleatëve strategjikë në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese të FARSH. Gjeneral Begaj theksoi se duke qenë të përgjegjshëm për rolin strategjik të Shqipërisë në rajon, vlerëson përfshirjen e portit të Durrësit dhe bazës ajrore të Kuçovës si infrastrukturë kritike në skenarin e

## GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ:

# Porti i Durrësit dhe baza e Kuçovës pjesë e stërvitjes "Defender 21"



Stërvitja "Defender 21", e drejtuar nga SHBA, do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të Aleancës për vitin 2021 dhe do të zhvillohet në territorin e 14 vendeve të Europës



stërvitjes. Gjithashtu, me prioritet do të jetë zbatimi i një protokollit të përbashkët i masave anti-COVID për të gjitha trupat pjesëmarrëse në stërvitje, duke përcjellë kështu mesazhe të unifikuara për përbalimin

e pandemisë. Stërvitja "Defender 21" e drejtuar nga SHBA do të jetë një ndër stërvitjet më të mëdha të Aleancës për vitin 2021 dhe do të zhvillohet në territorin e 14 vendeve të Europës.

**Gjeneralmajor Bajram Begaj-gjeneralmajor Gëzim Hazrolli**

## FA-FSK: Bashkëpunimi mes strukturave të inteligjencës ushtarake

*SHSHPEA Gjeneralmajor Bajram Begaj priti gjeneralmajorin Gëzim Hazrolli, drejtori Inteligjencës dhe Sigurisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës*

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj priti më 26 shkurt, në një takim, drejtorin e Inteligjencës dhe Sigurisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë takimit me drejtorin e Inteligjencës dhe Sigurisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Hazrollin, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Nga ana e tij, gjeneralmajor Hazrolli pasi e falënderoi gjeneralmajor Begajn për punën e mirë të bërë deri më tani si shef i Shtabit të Përgjith-

shëm të Forcave të Armatosura, shprehu gatishmërinë e tij për të vijuar bashkëpunimin e shkëlqyer të deritanishëm mes strukturave. Gjatë takimit Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të



Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneralmajor Bajram

Begaj, shprehu angazhimin e tij për vijimin e bashkëpunimit mes strukturave të inteligjencës ushtarake të dy vendeve duke inkurajuar punën e mirë që mund të bëhet për të intensifikuar këtë bashkëpunim. Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit ndanë të njëjtat qasje për situatën e sigurisë në rajon, rolin e NATO-s si dhe vijimin e bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës edhe në të ardhmen. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me Forcën e Sigurisë së Kosovës.



**NË FOKUS TË BISEDIMEVE ISHTE STËRVITJA "DEFENDER EUROPE 21"**

# Atasheu ushtarak i SHBA-së, James Hilton viziton Forcat Detare

**K**omandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Iliir Xhebexhia, paraditen e datës 11 shkurt 2021, priti në një vizitë kortezie atasheun ushtarak, kapiten i rangut të parë, James Hilton të shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendin tonë. Mbasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Detare, gjeneral brigade Xhebexhia shprehu kënaqësinë për nivelin e bashkëpunimit ndërmjet Forcës tonë Detare dhe Forcave ushtarake amerikane gjatë planizimit të stërvitjes "Defender Europe 21". Njëkohësisht edhe kapiteni i rangut të parë Hilton vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm për realizimin e kësaj stërvitjeje. Takimi vazhdoi me shkëmbim mendimesh për bashkëpunimin dhe stërvitjet e përbashkëta në muajt në vazhdim Lidhur me stërvitjen "Defender



Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021 ku do të marrin pjesë 6.000 trupa amerikane

Europe 21", në fillim të këtij muaji, konkretisht më 3 shkurt zhvilloi një vizitë në vendin tonë, Gjeneralmajor Joseph Jarrard, zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Forcave Tokësore Amerikane në Europë dhe Afrikë, ku u takua me Ministrin e Mbrojtjes, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ishte i pranishëm në takimin me antarë të Këshillit të Sigurisë Kombëtare ku morën pjesë zyrtarët më të lartë në vend dhe drejtues të institucioneve të sigurisë kombëtare. Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021 ku do të marrin pjesë 6.000 trupa amerikane. Paketa e stërvitjes drejtohet nga Komanda e Forcave

Tokësore Amerikane (US ARMY EUR) dhe përbëhet nga katër stërvitje kryesore të ushtrisë së SHBA-së, të cilat do të zhvillohen njëkohësisht të bashkërenduara me njëra-tjetrën dhe me stërvitje të tjera të NATO-s. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të demonstronë kapacitetet e vendit pritës, koordinuese dhe mbështetëse, të një stërvitjeje në shkallë të gjerë dhe komplekse, si dhe trajnimi për të gjithë komponentët dhe shërbimet, në stërvitje të përbashkëta dhe rajone të ndryshme. Risi e kësaj stërvitjeje do të jetë përfshirja e Qendrës së Kontrollit Raportimit të Forcës Ajrore në Sistemin e Komandimit të Kontrollit të operacioneve ajrore.



**A**mbasadorja e Republikës së Greqisë në Shqipëri Sophia Philippidou, ka vizituar Bazën Detare Pashaliman në të cilën gjatë prezantimit u njoh me historikun, kapacitetet, aktivitetet dhe projektet e modernizimit të Bazës së Pashalimanit për të ardhmen.

Ambasadorja u prit nga komandanti i Flotiljes Detare, kapiteni i rangut të II-të Sabri Gjinollari dhe zëvendëskomandanti kapiteni i rangut të III-të Blerim Hoxha.

Gjithashtu gjatë vizitës ambasadorja ishte e shoqëruar nga zëvendësambasadorja dhe atasheu ushtarak i Greqisë në vendin tonë. Gjatë takimit u mbajt një prezantim informues për ambasadorën dhe pjesëmarrësit mbi Flotiljen Detare dhe Bazën e Pashalimanit. Ambasadorja tregoi interes mbi historikun e pasur të bazës, kapacitetet dhe mbi projektet e modernizimit të saj. Së fundmi ambasadorja dhe ekipi i saj patën mundësi të vizitojnë mjediset e jashtme të Flotiljes.

## INTERES PËR BAZËN E PASHALIMANIT

# Ambasadorja e Greqisë, Philippidou viziton Bazën Detare Pashaliman



Ambasadorja Philippidou tregoi interes mbi historikun e pasur të bazës, kapacitetet dhe mbi projektet e modernizimit të saj



## SHSHPFA gjeneralmajor Bajram Begaj

# Inspektim në dy njësitë e reja pjesë e Forcës Tokësore

*Garnizoni i Komandës së Forcës Tokësore dhe Regjimenti i Operacioneve Speciale janë dy njësi të sapokrijuara brenda Forcës Tokësore*

**D**itën e premte, më 19 shkurt, SHSHPFA gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi një vizitë njohëse në garnizonin e Komandës së Forcës Tokësore dhe Regjimentin e Operacioneve Speciale, njësi kjo e sapokrijuar brenda Forcës Tokësore.

Qëllimi i kësaj vizite ishte dhënia e udhëzimeve për përforcimin dhe respektimin e masave protokollare kundër përhapjes së COVID-19, falënderimin e të gjithë efektivat të FT-së për punën e mirë dhe sakrificat që ata bëjnë çdo ditë, si në kuadër të përballimit të emergjencave civile, ashtu edhe në ruajtjen e gatishmërisë dhe kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore në zh-

villimin me sukses të misionit dhe detyrave në këtë periudhë delikate pandemie.

Gjatë kësaj vizite, gjeneralmajor Begaj inspektoi nga afër edhe gjendjen infrastrukturore të godinave në garnizon dhe punimeve që po kryhen për rikonstruksionin dhe rehabilitimin e tyre, si pasojë e dëmeve të

shkaktuara nga tërmeti i nëntorit të vitit 2019.

Pas prezantimit nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji të statusit aktual të punimeve të zhvilluara për çdo godinë të dëmtuar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj theksoi edhe

njëherë angazhimin e tij dhe të Shtabit të Përgjithshëm për të ndihmuar dhe çuar më tej këtë proces që të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur dhe sipas standardeve të kërkuara për vijimin sa më normal të punës së efektivëve të Forcës Tokësore.



Ushtria e SHBA-së i ka dhuruar Forcave të Armatosura të Shqipërisë 29 automjete, të njohura si "Humvee". Lajmin e ka bërë me dije Ambasada e SHBA-ve në vendin, ditën e enjte, më 25 shkurt 2021, duke shtuar se këto mjete dhe do të ndihmojnë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n.

"Njëzet e nëntë Automjete shumë-përdorimshe me lëvizshmëri të lartë (Humvee) mbërritën javën që kaloi, ditën e enjte, më 25 shkurt 2021 në Portin e Durrësit. Këto automjete janë dhurim për Forcat e Armatosura të Shqipërisë nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të ndihmojnë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n", -thuhet në njoftimin e Ambasadës Amerikane në Tiranë.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi në reagimin e tij shprehet se modernizimi i FA-së vijon dhe falë bujarisë së SHBA-së. "Modernizimi i Forcave tona të Armatosura vijon edhe falë bujarisë së popullit të SHBA-së. 29 automjete të blinduara, të lëvizshmërisë së lartë, mbërritën sot në portin e Durrësit, për të hyrë menjëherë në përdorim të Forcës Tokësore", -shprehet Peleshi në facebook.

Automjeti shumë-funksional, me lëvizshmëri të lartë (Humvee) është një mjet ushtarak me 4-rrota i prodhuar nga AM General. Në qershor 1981, ushtria amerikane lidhi një kontratë me AM Gjeneral dhe 55 mijëcopë automjete Humvee u prodhuan në vitin 1985. Humvee për herë të parë përdor në operacionin "Just Cause", në pushtimin e Panamasë në 1989.

Ai ka zëvendësuar mjetin M151 dhe M561 "Gama Goat". Kryesisht pëdoret nga ushtria e



## MODERNIZIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA

# Ushtria Amerikane dhuron 29 mjete "Humvee" për Forcat e Armatosura

***Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të ndihmojë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n***

SHBA-së, por gjithashtu ato përdoren edhe nga shumë vende të tjera, po kështu edhe nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Përdorimi i Humvee-s në Luftën e Gjirit Persik ndihmoi në promovimin e markës civile Hummer. Të paktën 17 variante

të Humveejanë nëshërbim me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Humveekonsiderohet si kali i punës për forcat e SHBA-ve në të gjithë botën. Më shumë se 10,000 të tillë u përdoren nga forca e koalicionit në Luftën Irakut.

# Kolonel Arben Zani-komandant i Regjimentit të Operacioneve Speciale

Në ambientet e Batalionit të Forcave Speciale, u organizua më 5 shkurt 2021, ceremonia e prezantimit dhe marrjes së detyrës së komandantit të Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani. Në këtë ceremoni morën pjesë, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, drejtori i Personelit në SHPFA kolonel Leonard Çoku, efektiv i Shtabit të Forcës Tokësore dhe komandantët e reparteve vartëse.

Ceremonia filloi me leximin e urdhrat të emërimit në detyrë të kolonel Arben Zani nga shefi i Personelit të Forcës Tokësore nënkolonel Dhimitër Selmanaj. Prezantimi i kolonel Zani, në detyrën e re, u krye nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili në fjalën e tij të rastit, e vlerësoi kolonel Zanin, si një kolonel që i përket spektrit të oficerëve profesionistë, të disiplinuar dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie. Këto cilësi sipas gjeneral brigade Kingjit kanë



shoqëruar kolonel Zanin në çdo detyrë që ai ka kryer gjatë karrierës së tij, duke filluar që nga pozicioni i komandantit të togës dhe deri tek detyra e tij më e fundit.

Nga ana e tij komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale të Forcës Tokësore falënderoi ministrin e Mbrojtjes, shefin e Shtabit të Përgjithshëm si dhe komandantin e Forcës Tokësore për besimin që kanë treguar me emërimin e tij në një strukturë të rëndësishme për FA siç është Regjimenti i Operacioneve Speciale. Ai garantoj se do të jetë gjithmonë në krye të punës dhe sfidave që koha do të sjellë për këtë njësi të sapo krijuar por dhe për Forcën Tokësore në tërësi. Kjo ceremoni u mbyll me një foto të përbashkët për të memorizuar këtë moment historik të riorganizimit të Forcës Tokësore.

## Emërohen dy komandantë të rinj në strukturat e Forcës Tokësore

*Nënkolonel Nebiaj në Batalionin e Mbështetjes dhe kolonel Dauti në Qendrën Stërvitore*

Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, u zhvillua më 8 shkurt 2021, ceremonia e marrjes së detyrës së komandantit të Batalionit të Mbështetjes me Shërbime të Forcës Tokësore, nënkolonel Manush Nebiaj. Në ceremoni mori pjesë, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, Shefi i Shtabit kolonel Ilirjan Dauti, përfaqësues nga Shtabi i Forcës Tokësore dhe pjesëtarë të këtij reparti. Ceremonia filloi me leximin e urdhrat të emërimit në detyrë të nënkolonel Manush Nebiaj nga shefit të Personelit të Forcës Tokësore nënkolonel Dhimitër Selmanaj.

Batalioni i Mbështetjes me Shërbime është një nga dy strukturat më të reja të krijuara në Forcën Tokësore, dhe si e tillë prezantimi i nënkolonel Nebiaj, në detyrën e re, u krye nga Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili në fjalën

e tij të rastit, e vlerësoi nënkolonel Nebiaj, si një nënkolonel me përvojë të gjatë ushtarake, të disiplinuar dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie. "Jam besim plotë që nënkolonel Nebiaj do e kryej këtë detyrë me përsosmëri pasi ka një eksperiencë të gjatë në këtë drejtim." – tha ndër të tjera gjeneral Kingji. Nga ana e tij komandanti i batalionit të Mbështetjes me Shër-



bime të Forcës Tokësore falënderoi Komandantin e Forcës Tokësore për besimin që e treguar me emërimin e tij në këtë strukturë të re të Forcës Tokësore dhe i siguroi se kjo njësi e re, nga sot, do të flasë vetëm me punë. Gjithashtu në ambientet e Qen-

dres Stërvitore, u zhvillua një tjetër ceremoni për marrjen e detyrës nga komandanti i ri, kolonel Ekland Dauti. Edhe kjo ceremoni u përshëndet nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i cili falënderoi punën e palodhur të komandantit pararendës kolonel David Rroku. "Qendra Stërvitore është një nga repartet më të kompletuara dhe me ambientet më bashkëkohore.

Kjo falë punës Tuaj të palodhur dhe padyshim falë mbështetjes së pandërprerë të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes." - u shpreh gjeneral Kingji. Komandanti i sapoemëruar i Qendrës Stërvitore, kolonel Ekland Dauti vjen nga një rrugëtim i gjatë në karrierën ushtarake. Ai ka ushtruar detyra si komandant në batalionin e Forcave Speciale dhe Policin Ushtarake, zëvendës komandant i kësaj Qendre dhe së fundmi Shef i Operacioneve në Forcën Tokësore.



# Mbyllet me sukses Kursi i 45-të i Avancuar i Nënoficerit

**M**ë datë 9 shkurt 2021 mbyllet me sukses Kursi i 45-të i Avancuar i Nënoficerit, në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve. Në ceremoninë e përfundimit të këtij kursi mori pjesë Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve Kolonel Arben Toska si dhe stafi mësimdhënës, mbështetës dhe kursantë.

Në fjalën e tij kolonel Toska vlerësoi punën e bërë nga kursantët në përvetësimin e programit mësimor. Ndër të tjera ai tha: "Aktualisht një ndër risitë e arsimimit në FA është përfshirja e një numri më të madh të grave dhe vajzave, të cilat stërviten, garojnë, konkurojnë, dhe shërbejnë njësoj si burrat nën uniformë, gjë e cila u evidentua qartë në këtë kurs me pjesëmarrjen e 15 grave dhe vajzave." Kursi i Avancuar, u zhvillua në QAPN për një periudhë 8-javore (pjesa e parë e lidërshiptit) dhe ka si qëllim përgatitjen e nënoficerëve në rolin e zëvendëskomandantit të togës. Në këtë kurs morën pjesë nënoficerë me gradën "tetar".

Ndërkohë më datën 15 shkurt u hap Kursi 46-të i Avancuar i Nënoficerit, i cili zhvillohet në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve për një periudhë 8 javore. Fokus i tij është marrja e njohurive dhe përgatitja e nënoficerit në rolin e zëvendëskomandantit të togës.

Në këtë kurs marrin pjesë 37 kursantë nënoficerë me gradën "tetar", të cilët vijon nga të

“ Kursi i Avancuar i Nënoficerit i cili zgjati 8 javë u evidentua për pjesëmarrjen e 15 grave dhe vajzave



gjithë njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura. Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve vijon të zbatojë me

intensitet dhe përkushtim të plotë planin e arsimimit për vitin 2021, duke zbatuar me rigorozitetet protokollat Anti-Covid.



**D**itën e premte, më datë 5 shkurt 2021, në mjediset e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të 8-të të Kryekapterit.

Në këtë ceremoni mori pjesë Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Gjeneral brigade Albert Mullai, Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve Kolonel Arben Toska, si dhe personeli drejtues dhe mësimdhënës i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve.

Fjalën e hapjes e mbajti Instruktori Përgjegjës i Kursit Kryekapter Enver Rama, i cili tha: “Vlerësoj punën në grup të kursantëve të cilët treguan pjekurinë profesionale, ushtarake e njerëzore, në përputhje me moshën dhe vjetërsinë e shërbimit të secilit prej tyre në Forcat e Armatosura”.

Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Gjeneral brigade Albert Mullai, u shpreh se “Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve është një njësi e konsoliduar dhe me eksperiencë, në arsimimin profesional të nënoficerëve në FA”.

Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve në fjalën e tij tha: “Për ne nuk ka investim më të rëndësishëm se sa në arsimim dhe dije, pasi në vlerësimin e leadershipit ushtarak të Forcave të Armatosura, ju jeni pjesa më e rëndësishme e

## Përfundon Kursi i 8-të 4 javor i Kryekapterit



Gjeneral brigade Albert Mullai: “Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve është një njësi me eksperiencë në arsimimin profesional të nënoficerëve në FA”



korpusit të nënoficerëve, shtylla kurrizore e FA-së. Ndaj të gjitha përpjekjet tona shkojnë në drejtim të zhvillimit dhe arsimimit tuaj”. Kursi i Kryekapterit, u zhvillua në

Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve për një periudhë 4-javore dhe pati si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të Kryekapterit.

### Akademia e Forcave të Armatosura

## Fillon Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit

*Kursi përbëhet nga pjesëmarrës të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës*

**N**ë Akademinë e Forcave të Armatosura ka filluar më 8 shkurt 2021, procesi mësimor me kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit.

Pjesëmarrësit nga Forcat e Armatosura Shqiptare dhe ato të Forcës së Sigurisë së Kosovës, do të ndjekin procesin mësimor online nga data 8 shkurt 2021 deri 14 maj 2021.

Në ditën e parë të kursit u bë



prezantimi i programit mësimor dhe mënyra e zhvillimit të tij. Mësimi dhe stërvitja do të zhvillohen duke respektuar udhëzimet e dhëna në lidhje

me masat parandaluese ndaj “COVID-19”. Qëllimi i këtij kursi është përgatitja e oficerit të shtabit të batalionit për përmbushjen e kërkesave të drejtimit, koordinimit, planëzimit dhe stërvitjes në nivel taktik do të shërbejë rritjes profesionale për realizimin e

detyrave në përmbushje të misionit që këta oficerë kanë në Forcat e Armatosura.

## **Zhvillohet stërvitja ajrore në rrugë-kalim "Një ekip-Një mision"**

**P**ersoneli, pilotët, operatorët, teknikët e Forcës Ajrore shërbejnë dhe kryejnë gjithmonë detyra të rëndësishme operacionale të gërshetuara me programin stërvitor. Kështu, paraditen e datës 14 shkurt, pilotët e Forcës Ajrore zhvilluan stërvitjen ajrore në rrugë-kalim, me moton "One team-One mission", "Një ekip-Një mision", stërvitje kjo, jo vetëm trajnuese por paralelisht për të mbështetur edhe efektivat e Forcës Ajrore, të cilët kryejnë shërbimin e tyre në zona të largëta dhe të vështira, të cilët në këto kushte tepër vështira të motit, me temperatura ekstremisht të ulëta dhe reshje dëbore jo të zakonshme mundësojnë funksionimin e sistemeve të vëzhgimit ajror, ndërlidhjes dhe shkëmbimit të informacionit. Gjatë stërvitjes u mundësia edhe dërgimi i materialeve shtesë si veshje të ngrohta, medikamente mjekësore dhe materiale të tjera logjistike, për të mos qenë të papërgatitur në këto kushte ekstreme. Me këtë mision Forca

Gjatë stërvitjes u mundësia dërgimi në zonat e mbuluara nga dëbora të materialeve shtesë: si veshje, medikamente mjekësore dhe materiale të tjera logjistike



Ajrore përcjell mesazhin se, në dëborë e kudo, por pas tyre djemtë dhe vajzat e Forcës është e gjithë forca pasi për ata Ajrore nuk janë vetëm në mal, "Misioni është i pari".

## **"Politika e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare"**

**M**ë datë 16 shkurt në auditorët e AFA në zbatim të programit mësimor dhe të masave anti-covid u zhvillua provimi i radhës në modulën e parë "Politika e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare" me kursantët e KSHP. Nga ana e departamentit të Strategjisë Studimeve të Avancuara dhe Historisë ishin marrë të gjitha masat për zhvillimin e provimit, duke respektuar numrin e kursantëve dhe distancimin në auditore. Pjesëmarrja në provim, serioziteti në zhvillimin e tezave tregoi edhe një herë se pavarësisht kushtëzimeve që ka krijuar koha,



përkushtimi për të arritur rezultate sa më të mira, dominonte tek çdo kursant. Aktualisht zhvillimi i

programit mësimor më të gjitha kurset që zhvillohen në AFA vijon të bëhet online.



**D**rejtor i Emergjencave Civile, Haki Çako u shpreh në "Euronews Albania" më 3 shkurt, se ende në qarqet Shkodër dhe Lezhë ka zona të përmbytura. "Tashmë fillon faza e rehabilitimit dhe përmirësimit të të gjithë sipërfaqeve të mbuluara me ujë. Ka filluar rënia e nivelit të ujërave, edhe në ambiente ku ka banesa, kryesisht në zonën e NënShkodrës", u shpreh zoti Çako. Sa i përket furnizimit me ushqim për bagëtitë ai nënvizoi se "nuk ka pasur mungesë të bazës ushqimore në të gjithë zonën, kryesisht në atë të Shkodrës". Për çështjen e dëmshpërblimeve, kreu i Emergjencave Civile tha se prezenca e ujit e ka bërë të vështirë vlerësimin e dëmeve në terren. Por, zoti Çako deklaroi se kompesinimi i fermerëve apo banorëve do të bëhet sipas ligjit. "Ju siguroj

## Haki Çako: Fermerët e dëmtuar do të dëmshpërblehen sipas ligjit

Shkodra dhe Lezha janë dy prej qarqeve, të cilat po vuajnë më shumë pasojat e reshjeve të ditëve të fundit.



që vlerësimi është maskimal, do të merren në konsideratë të gjitha kapacitetet dhe hapësirat që parashikon ligji dhe të gjitha hapësirat që ka adresuar qeveria shqiptare në buxhetet e njëjste

të pushtet vendor, por edhe kapacitete të tjera", përfundoi zoti Çako. Shkodra dhe Lezha janë dy prej qarqeve, të cilat po vuajnë pasojat e reshjeve të ditëve të fundit.

**N**ë mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore po zhvillohen kurset institucionale të oficerit në specialitetet Këmbësori dhe Zbulim, si dhe Kursi Bazë dhe i Avancuar i Nënoficerit. Kursi Bazë dhe Kursi i Avancuar i Nënoficerit, që kanë filluar në datën 25 janar 2021 kanë një program të shtrirë në një periudhë 8-javore. Në këto kurse zhvillohen temat mësimore në module teorike dhe praktike. Qëllimi i kurseve është përgatitja e nënoficerit për drejtimin e trupave në nivel skuadër dhe togë këmbësorie. Kursi Bazë i Oficerit është një nga kurset më të gjata që zhvillohen në Qendrën Stërvitore dhe zgjat 18 javë. Në këtë kurs trajtohen temat e lidershipit ushtarak, taktikë, alpinizëm, përgatitje fizike dhe zbulim. Qëllimi i Kursit Bazë të Oficerit është përgatitja e oficerit në rolin e

## Kurse institucionale të oficerit në specialitetet Këmbësori dhe Zbulim

Kursi Bazë i Oficerit është një nga kurset më të gjata që zhvillohen në Qendrën Stërvitore dhe zgjat 18 javë



komandantit të togës. Kurset institucionale shërbejnë për formimin ushtarak si dhe janë të

rëndësishme pasi janë në funksion të marrjes së të gradës së radhës.



## ME HERONJTË E HELIKOPTERIT AS 532 AL

# Forcat Ajrore në luftë për të shpëtuar jetët njerëzore

“ Helikopterët e Forcave Ajrore drejtohen nga një personel i përgatitur profesionalisht, i përkushtuar për zbatimin e detyrave

**H**elikopterët e Forcave Ajrore drejtohen nga një personel i përgatitur profesionalisht, i përkushtuar për zbatimin e detyrave.

Ata janë njerëz të zakonshëm që në ditë të jashtëzakonshme janë pranë komunitetit, në çdo rast e në çdo kohë, por kjo më e theksuar sidomos në përmbytjet e krijuara në zona të ndryshme të vendit, ku rrezikohet jeta e banorëve, jo vetëm këtë vit por edhe vite më parë.

Një prej tyre është reshter Bledi Zaimi, aereoshpëtues në grupin e helikopterëve AS 532 AL dhe tetar Ermir Locaj, vinçier në grupin e helikopterëve AS 532 AL të cilët tregojnë vështirësitë por edhe gëzimin kur shpëtojnë jetë njerëzore.

Këta njerëz me uniformë ushtarake shkëputen nga toka për të

kapur qiellin, për të qënë heronj në ditë të vështira.

Reshter Bledi Zaimi, aereoshpëtues në grupin e helikopterëve AS 532 AL kujton një prej rasteve të vështira dhe tregon dinamikën e operacionit që nga marrja e informacionit e deri në mbylljen me sukses të operacionit: “Na vjen njoftimi që në zonën e Marllkuçit rrezikohet jeta e një familjeje dhe në jetën time nuk isha përballur me një përmbytje aq të madhe. Në mënyrë urgjente morëm të gjitha masat, u ngritëm në ajër me helikopter dhe duke ndjekur koordinatat arritëm tek familja e parë ku ndodheshin 8 persona në zonën e rrethuar me ujë nga të katër anët. Vendosëm se kush ishte më prioritar dhe këta ishin gratë dhe fëmijët.”

Tetar Ermir Locaj, vinçier në grupin e helikopterëve AS 532 AL, thotë se kishte shumë vështërsi për tu ulur: “Kishte shumë vështërsi, telat elektrike në njërën anë, në anën tjetër pemët, tejdukshmëria e ulët, etj. Dolën banorët dhe po kërkonin ndihmë. Ka zbritur Bledi dhe arritëm të komunikojmë me familjarët të cilët ishin shumë të rënduar psikologjikisht dhe fizikisht, morëm një fëmijë të vogël me nënën e vet, pastaj familjarët e tjerë. Shpëtimi i jetës së njerëzve është primare”, -u shpreh tetar Ermir Locaj.

Tëshpëtosh jetë dhe të shikosh që shpresa rilind sërish nuk është thjeshtë një punë por njëmision i rëndësishëm për të cilin ata ndihen krenarë.

# Nga segmenti rrugor Theth-Bogë deri në Obot dhe Trebinjë

Komanda Mbështetëse do vazhdojë operacionet në mbështetje të popullsisë deri në qetësimin e situatës dhe rikthimin e saj në normalitet

**N**ë këto ditë të vështira të krijuara nga reshjet e shumta të dëborës dhe temperaturat e ulëta të shoqëruara me ngrica, forcat e Komandës Mbështetëse kanë dalë në terren për të ndihmuar në zhbllokimin e akseve rrugore me të prekura në vend nga bllokimi prej dëborës. Komanda Mbështetëse ka angazhuar mjetet borëpastruese dhe mjete të rënda për hapjen e rrugëve në zonat e thella, kryesisht në qarqet Korçë, në aksin rrugor Korçë -Kapshticë dhe në fshatrat e njësisë administrative Trebinjë-Pogradec.

Gjithashtu forcat e Komandës Mbështetëse vijojnë punën në Shkodër për hapjen e segmentit rrugor Theth-Bogë ku në disa zona kalimi është bërë i pamundur për shkak të trashësisë së borës e cila ka arritur deri në 3 metra. Po kështu gjatë këtyre ditëve efektivët e Komandës Mbështetëse kanë vijuar operacionin për transportin me barka të banorëve në Obot, Shkodër.



Efektivët e Komandës Mbështetëse janë angazhuar edhe në operacionin e shpërndarjes së pakove ushqimore në zonat Lezhë, Mirditë, Rrëshen, Laç, Kurbin, si dhe Shkodër, Vau-Dejë. Komanda Mbështetëse do

të vazhdojë angazhimin e saj me operacionet e lartpërmendura në mbështetje të popullsisë e në bashkëpunim me pushtetin lokal, deri në qetësimin e situatës dhe rikthimin e saj në normalitet.

## Strukturat e Komandës Mbështetëse

**S**trukturat e Komandës Mbështetëse kanë vënë në gatishmëri të gjitha kapacitetet operacionale me mjete dhe forca për përballimin e situatës së krijuar gjatë këtyre ditëve, në operacionin në ndihmë të popullsisë në zonat e përmbytura për shkak të reshjeve të dendura të shiut.

Efektivët e strukturave të Komandës Mbështetëse kryesisht është angazhuar në kryerjen e evakuimit të popullsisë, si dhe shpërndarjen e pakove ushqimore për banorët e Obotit në Shkodër të cilët janë të izoluar nga niveli i lartë i ujit -situatë kjo e krijuar për shkak të reshjeve. Me një nga varkat e batalionit të BMR është bërë evakuimi i një fëmije të sëmurë për në poliklinikë më pas drejt spitalit, e cila jetonte në një nga shtëpitë e

# Angazhim në ndihmë të banorëve për përballimin e përmbytjeve



izoluara nga uji prej ditësh Efektivët e Komandës Mbështetëse ndodhen në gatishmëri për t'u përgjigjur çdo situatë të krijuar nga reshjet.

Por gjatë ditës së enjte, më 11

shkurt, reshjet gjatë 24 orëve krijuan probleme të shumta në qytetin e Shkodrës. Prurjet në lumenj kanë qenë të mëdha aq sa lumi Buna ka dalë nga shtrati dhe niveli i liqenit të Shkodrës u rrit ndjeshëm duke shkaktuar përmbytje të disa rrugëve të qytetit si në Livadhe, Xhabije, Tophanë, Zoteknikë, Tepe, Perash ku janë evakuuar nga shtëpitë e tyre në qytet mbi dhjetë familje tek të afërmit e tyre dhe në strehime të tjera dhe forcat ushtarake kanë punuar për largimin e tyre nga shtëpitë të cilat kanë patur prezencë uji në oborre, duke parandaluar dëmtimin e disa banesave.





## RËNDOHET SITUATE E RESHJEVE NË SHKODËR

# Forcat e Armatosura nisin evakuimet e banorëve dhe bagëtive

**R**eshjet e dendura kanë sjellë, dje, ditën e enjte përkeqësim të situatës së përmytjeve në bashkinë e Shkodrës. Forcat e Armatosura kanë shtuar praninë në terren për t'i ardhur në ndihmë banorëve të prekur dhe pushtetit lokal për të përballuar situatën.

Trupat dhe mjetet e Batalionit të I-rë të Këmbërorisë së Vaut të Dejës (b1k) evakuuan 10 familje në lagjen "Iliria" të qytetit të Shkodrës, të cilat u transportuan për t'u strehuar në konviktin e Universitetit "Luigj Gurakuqi". Gjithashtu, trupat dhe mjetet e Batalionit të I-rë të Këmbërorisë së Vaut të Dejës (b1k) evakuuan rreth 150 krerë bagëti e imët nga lagjja e njohur si Livadhet pranë bregut të liqenit në qytetin e Shkodrës. Në njësinë administrative Dajç, trupat dhe mjetet e b1k evakuuan rreth 2000 shpendë nga një fermë private, për t'i dërguar në fshatin Shirq.

Në fshatin Obot të njësisë administrative Ana e Malit vijon transporti i banorëve për nevojat e tyre të përditshme nëpërmjet mjeteve lun-



BMR ka angazhuar në bashkinë e Shkodrës 7 mjete lundruese, të cilat mundësojnë lëvizjen e banorëve dhe janë në gatishmëri për çdo evakuim të mundshëm

druese të batalionit të mbështetjes rajonale (BMR) dhe mjeteve të kalueshmërisë së lartë të b1k. BMR ka angazhuar në bashkinë e Shkodrës 7 mjete lundruese, të cilat mundësojnë lëvizjen e banorëve dhe janë në gatishmëri për çdo evakuim të mundshëm.

Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, i shoqëruar nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile Haki Çako dhe prefektja e qarkut Majlinda Angoni po

ndjekin situatën në zonat e përmytura në bashkinë e Shkodrës. Në gjithë qarkun e Shkodrës janë 5030 ha sipërfaqe totale e përmytur, ndërkohë që ka prani të ujit në disa banesa në lagjet e qytetit dhe në njësitë Ana e Malit dhe Dajç.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me pushtetin vendor po monitoron situatën dhe po koordinon punën për përballimin sa më të mirë të gjendjes së shkaktuar.



# Mesazh urimi me rastin e 8 marsit “Për ju koleget e mia që shërbeni në Forcat e Armatosura”

Ky 8 mars i gjen femrat ushtarake në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Afganistani, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit.



Gjeneral Brigade MANUSHAQE SHEHU  
Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të  
Forcave të Armatosura

8 marsi njihet si “Dita Ndërkombëtare e Gruas”, ditë kur të drejtat e gruas u vunë në agjendën e ditës të politikës mbarëkombëtare. 8 marsi është një ditë e shënuar edhe për gratë shqiptare, të cilat nga dita në ditë e gjejnë veten e tyre më të vlerësuar e më të ndërgjegjshme për rolin e tyre në jetë e shoqëri.

Në këtë kuadër edhe gratë ushtarake dhe civile, ky 8 mars, megjithëse në kushte të veçanta për shkak të COVID-19, i gjen më optimiste për të ardhmen e tyre. Në këtë ditë të shënuar, dëshiroj t’ju drejtohem juve, jo vetëm si Zëvendës shefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e si gjenerale, por si njëra prej jush, si grua, kolege, nënë e motra juaj “Gëzuar festën e Nënës”, Shëndet e lumturi paçi në çdo aspekt të jetës tuaj familjare e shoqërore”!

Në mënyrë të veçantë dëshiroj të përshëndes femrat ushtarake dhe civile, të cilat ky 8 mars i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Afganistani, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit. Por ky 8 mars na gjen me fëmërën e parë kandidatë për pilote, e cila krahas meshkujve do të përgatitet si pilotja e parë në institucionet arsimore ushtarake shqiptare.

Ashtu sikundër dua të uroj e përshëndes edhe gjithë ato femra ushtarake dhe civile që gjatë këtyre ditëve të fundit, janë përfshirë në përballimin e emergjencave civile si të barabartë e përkrah kolegëve të tyre meshkuj.



Ky 8 mars një pjesë të femrave i gjen në ndjekje online të kurseve të karrierës ushtarake, disa duke kryer po online punën nga shtëpia, disa në krye të detyrave në zyrë, në fushat e poligonet e stërvitjes, në mënyrë të veçantë në përgatitjen për pjesëmarrjen në stërvitjen më të madhe ushtarake të drejtuar nga ushtria e SHBA-së në Europë "Defender 21", në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore, i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojes e kudo tjetër ku është nevoja dhe ku e kërkon funksioni organik, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment nga kryerja e detyrave. Por disa gra i gjen edhe të prekura apo të vetëkarantinuara nga sëmundja famëkeqe e COVID-19, ose duke u shërbyer familjarëve të tyre, ashtu siç gjen plot mjekte e infermiere ushtarake duke qenë në vijën e parë të luftës ndaj kësaj sëmundjeje të pamëshirshme, të cilat gjej rastin t'i përsëritet e t'i falënderoj për përkushtimin e humanizmin e treguar ndaj detyrës. Pra ky vit ka qënë i pazakontë, por në të njëjtën kohë vit reflektimi ndaj situatës së krijuar për shkak COVID-19, ruajtja e shëndetit tuaj dhe e të dashurve t'uaj ka shumë rëndësi. Kemi humbur të afërm, miq, por do ti kujtojmë me kujtimet e tyre të bukura me shpresë se kjo situatë nuk do të zgjasë, duke krijuar mundësinë të kthehemi në jetën normale.

Në këtë 8 mars gjej rastin të falënderoj titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për kujdesin e mbështetjen e treguar ndaj femrave ushtarake dhe civile, si në rekrutimin, promovimin dhe ecurinë e tyre në detyrë e karrierë. Puna që bëhet për zbatimin e Planit të Veprimit Kombëtar e Planit të Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për Gruan, Paqen e Sigurinë", ka bërë të mundur që gratë ushtarake dhe civile të zenë sot rreth 14.1% të numurit të përgjithshëm të personelit ushtarak aktiv me objektiv e synim për të artitur 15%.

Gjithashtu miratimi para një viti nga Ministri i Mbrojtjes të dokumentit "Politikat dhe procedurat për eliminimin e dhunës,

ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës të strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura", u ka dhënë femrave më shumë siguri, përkujdesje e mbrojtje nga strukturat shtetërore.

Ku nuk i gjen sot femrat ushtarake dhe ato civile? Ato i gjen, jo vetëm nëntogere, togere, kapitene e majore, por edhe me grada të larta e madhore si nënkolonele, kolonele e deri gjenerale, i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagogje, me grada shkencore, drejtore drejtorish, atashe ushtarake etj.

Ashtu sikurse femrat ushtarake në rezervë i gjen sot deputete, biznesmene, por edhe shtëpiake të papuna. 8 marsi është festë për të gjitha, prandaj në këtë ditë të shënuar një urim special dëshiroj t'u jap gjithë atyre ushtarakeve

ëve tanë një trajtim më human e njerëzor.

Prandaj në këtë 8 Mars, që nuk duhet t'a konsiderojmë vetëm si ditë feste, por edhe si ditë të manifestimit të kërkesave tona, ju bëj thirrje grave ushtarake e patjetër edhe atyre civile: Luftoni e kontribuoni më shumë për veten tuaj! Mos pushoni së studiuar për të arritur me punë e mundim çdo ambicie profesionale e të karrierës edhe atë që konsiderohet e paarritshme! Luftoni dhe kërkoni të gjejnë zbatim të gjitha ligjet në fuqi që u japin të drejta grave ashtu si edhe burrave! Luftoni e kërkoni që promovimi në detyrë e gradë të mos konsiderohet si "lëmoshë e mëshirë" ndaj femrave, por si një e drejtë që ju takon dhe e meritoni! Luftoni dhe kërkoni që edhe në familje të mos jeni pre e dhunës dhe e diskriminimit, siç ndodh në ndonjë rast edhe ndaj



femra, ushtarake profesionale, nënoficere e oficere, të cilat për arsye ligjore e kanë ndërprerë karrierën ushtarake ose që për arsye moshe kanë dalë në pension "Gëzuar festën e Nënës, vlerësim e mirënjohje për kontributin e dhënë në vite si pjesë e Forcave të Armatosura! Krenare që i keni shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut, duke sakrifikuar jo në pak raste veten dhe familjen Tuaj! Qofshi përjetë të lumtura, si nëna e si gjyshe"!

Megjithëse trajtimi dhe vlerësimi që u bëhet sot femrave, ka njohur gjithmonë përmirësim e rritje si në aspektin ligjor, ashtu edhe në zbatimin praktik, përsëri ka vend që si gra të mos reshtim së kërkuar ndaj strukturave shtetërore, por edhe në familje ndaj bashkëshort-

femrave ushtarake dhe civile! Kurrë mos pranoni dështimin në karrierën tuaj! Edhe nëse ndodh përpikuni për të bërë të pamundurën. Dështimi juaj duhet të jetë sfidë për të tjerat!

Ambiciet tona si individë, në pozicionin e punës, por edhe në grup si gra duhet të jenë të arrijmë gjithçka që është e mundur, gjithmonë të tregojmë me aftësi e me punë se jemi në gjendje të bëjmë punë të dobishme ndaj shoqërisë dhe atdheut, aq sa edhe burrat.

Por kur këto t'i kemi arritur të dimë t'i vemë në zbatim e të mos zhgënjëjmë në besimin e dhënë ndaj nesh. Mos mendoni asnjëherë se si gra kemi arritur çdo gjë në mbrojtjen e të drejtave tona. Lufta dhe përpjekjet tona duhet të vijojnë edhe në të ardhmen.



## Rëndësia e profesionit: Ta duash atë dhe të japësh më të mirën nga vetja

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

**M**ajore Enkelejda Tyrku është pedagoge në AFA, e cila spikat me korrektësinë, përkushtimin dhe angazhimin maksimal në stafin akademik, gjë që e bën figurën e saj si ushtarake, grua dhe nënë, të respektuar dhe vlerësuar që nga koha kur ka veshur mbi supë uniformën e ushtarakes. Majore Enkelejda ka ndjekur studimet në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Histori-Filologjisë, dega Histori dhe më pas ajo ka ndjekur studimet pasuniversitare në Akademinë Ushtarake Skënderbej 2003-2004, si dhe më pas ka përfunduar kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Leavenworth, Kansas. Ka kryer funksione të ndryshme në Brigadë dhe Batalion Artilerie, si specialiste personeli dhe me vonë specialiste stërvitje. Ka punuar në batalionin e dytë të këmbëtorisë në Brigadën e Reagimit të Shpejtë dhe më vonë në KDS. Ajo është një nga ushtaraket femra të FA-së që ka marrë pjesë në dy misione të NATO-s në Afganistan. Nga 2014 e në vijim ajo është pedagoge për Historinë Ushtarake në AFA.

**Majore Enkelejda Tyrku, mirë se erdhët në faqet e shtypit ushtarak. Ju jeni pedagoge në AFA dhe ne ju kemi zgjedhur pikërisht**

“**Intervistë me majore Enkelejda Tyrku, pedagoge në Akademinë e Forcave të Armatosura**



**ju në prag të 7 dhe 8 Marsit për të ndarë eksperiencën tuaj me lexuesin ushtarak dhe jo vetëm. Çdo të thotë për ju, të përçosh dije tek ushtarakët e rinj?**

Gjatë shërbimit tim 17 vjeçar në

Forcat e Armatosura, mësimdhënia është një nga eksperiencat ku kam mësuar dhe më ka shërbyer për tu rritur profesionalisht. Është një profesion i dyfishtë, je pjesë e botës së bukur të artit të mësimdhënies dhe njëkohësisht pjesë e pandërprerë



dhe aktive e misionit fisnik të Forcave të Armatosura. Çdo ditë puna në auditor është një kënaqësi më vete. Në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura ulen tani edhe studentët e programit të studimeve Bachelor në “Studime në Shkencat Ushtarake”, që i jep Akademisë një dimension të ri por edhe i rikthehet traditës shumëvjeçare të arsimit ushtarak. Çdo ditë duke punuar me studentët e të gjitha niveleve, mësoj dhe marr shumë informacion dhe shkëmbim eksperiencash që më ndihmojnë të zgjeroj këndvështrimin tim jo vetëm si mësimdhënëse por edhe si oficere dhe individ që të arrij një botëkuptim më të gjerë. Stafi i Akademisë është si një familje e madhe, ku çdo pjesëtar vazhdon të japë kontributin për të realizuar misionin e AFA-së dhe për të vazhduar me trashëgiminë e lënë nga puna e ndërtuar nga një gjeneratë e tërë pedagogësh. Në objektivat e mia të rëndësishme, është leximi dhe hulumtimi në mënyrë rigoroze. Çdo ditë në programin tim, studimi zë një pjesë të rëndësishme dhe është burim vital që më jep edhe mundësinë që të hedh themelet solide për vetë-zhvillim. Kjo pjesë është shumë e rëndësishme që të angazhohem në mënyrë aktive dhe dinjitozë në zhvillimin e programit akademik. Ndihej me fat dhe shumë mirënjohëse, që jam pjesë e stafit të Departamentit të Strategjisë, Studimeve të Avancuara dhe Historisë Ushtarake. Diskutimet dhe bisedat e

përditshme akademike me kolegët e Departamentit, e bëjnë ditën time gjithnjë e më interesante. Puna kërkimore, hulumtimet dhe analizat e argumentuara prej secilit prej tyre në lidhje me tematika të ndryshme që trajtohen në programet mësimore është një thesar më vete dhe me vlera të mëdha për mua.

**Si po zhvillohet mësimi aktualisht, sa efektive janë kurikulat, pasi jemi në një situatë të pazakontë pandemie të COVID-19, për mësimdhënien online?**

Situata e krijuar për shkak të Pandemisë globale të COVID-19, ka ndikuar në të gjitha sferat e jetës dhe sigurisht ka pasur një ndikim të madh edhe në fushën e mësimdhënies. Një sfidë që po e përballojmë të gjithë së bashku. Mësimdhënia në këto kushte ka pjesën e vet të vështirësive dhe barrën e saj të sfidave, si për stafin akademik ashtu edhe për vetë studentët. Megjithë këto vështirësi që kanë prekur jetët dhe sigurinë shëndetësore të familjeve dhe të dashurve tanë, procesi mësimor vazhdon dhe të gjithë ne po përpiqemi të përshtatemi me kushtet dhe vështirësitë që sjell mësimi në distancë. Bashkëpunimi midis stafit të AFA-së por edhe studentëve na ndihmon që ti përballojmë edhe këto sfida. Për një pedagog prania e studentëve në auditor është më rezultative, por kjo situatë është edhe një lloj testimi, që pavarësisht vështirësive, ne të vazhdojmë dhe

të ecim me përmbushjen e misionit akademik.

**A është i vështirë profesioni i ushtarakut? Si është për ju të jeni ushtarake, nën uniformë dhe nënë?**

Profesioni i ushtarakut është në mënyrë të barazvlefshme i vështirë edhe i bukur njëkohësisht. Është kompleks dhe shumë sfidues, por me përkushtim dhe me punë të vazhdueshme është i mundur. Fillimet janë gjithmonë të vështira. Shpesh në vitet e para të shërbimit si oficere e re, i drejtoja pyetjen vetes: “A do të mundesh t’ia dalësh me sukses? A do të jem e denjë dhe do ti përmbush të gjitha kërkesat që më ofron detyra ime? Përgjigjet i mora me kalimin e kohës. I lejoja vetes time kohë, që vit pas viti të shikoja anët pozitive dhe tëndiqja dritën jeshile “shpresën” që do të më udhëhiqte në të ardhmen dhe në ditët e bukura kur do t’i merrja të gjitha përgjigjet e pyetjeve që më kishin munduar në fillimet e karrierës time. Uniforma bëhet pjesë normale e jetës dhe shpesh kur shikoj njerëz në uniformë, më jep ndjesinë sikur janë njerëz të afërt dhe që i përkasin familjes time të madhe dhe të vogël “të vëllezërve dhe motrave nën armë”. Profesioni i ushtarakut me larmishmërinë e specialiteteve që ofron nën uniformë, është një hapësirë e madhe për të përfituar nga gama e gjerë e eksperiencave dhe ekspertizës që sjell çdo ushtarak. Ruajtja e balancës midis

profesionit, sfidave e sakrificave që kërkon uniforma me të qenit nënë dhe familjare është pjesa më delikate. Shpesh më është dashur që të luftoj me veten për të dhënë më të mirën dhe për të mos lënë mënjanë të dy këto pjesë të rëndësishme të jetës. Është një luftë e përditshme, që akoma vazhdon të ketë gjithmonë vëmendjen dhe dedikimin tim maksimal për të siguruar më të mirën për të dyja këto role.

### **Kush ka qenë sfida më e madhe e punës tuaj?**

Sfidat janë pjesë normale e jetës. Sfida kam hasur shumë, por secila prej tyre më ka ndihmuar që të rritem, maturohem dhe të jem edhe më e përgjegjshme si individ dhe si ushtarake. Pas shumë viteve në shërbim aktiv në Forcat e Armatosura dhe përvojave që kam fituar, ndihem se jam bërë pjesë me të drejta të plota e Forcave të Armatosura. Gjithmonë do të jem falenderuese dhe mirënjohëse të gjithë atyre kolegëve/kolegeve, miqve/mikeshave, eprorëve dhe drejtuesve që më kanë ndihmuar në rrugëtimin tim. Çdo kritikë, çdo sugjerim, këshillim dhe asistencë më kanë ndihmuar të jem kjo që jam sot. Falenderime pafund për të gjithë. Në eksperiencën personale, sfida më e vështirë mbetet misioni im i parë në Komandën e NATO-s, në kuadër të ISAF, në Kabul në Afganistan. Lashë vajzën time të vogël vetëm 1 vjeçe e gjysmë dhe ky është një ndër momentet më të vështira që nuk do të largohet ndonjëherë nga kujtesa time. Sot që ajo është 10 vjeçe, shpesh më pyet për punën time dhe vështirësitë që has. E shikoj shumë të interesuar dhe kurioze për profesionin tonë dhe uniformën ushtarake. E kam falenderuar vajzën time Antean dhe i shpjegoj që edhe ajo ka dhënë një kontribut të madh dhe ka sakrifikuar shumë, si një heroinë e vogël, për të mbështetur në misionin tonë të përbashkët.

**Ju keni 17 vite shërbim në Forcat e Armatosura shqiptare dhe 2 misione ushtarake të rëndësishme duke dhënë kontributin**

### **tuaj në strukturat e paqes së NATO-s në Afganistan. Si ka qenë kjo eksperiencë?**

Dy shërbimet paqeruajtëse në Afganistan, janë një moment kthese dhe një faqe e re në karrierën time ushtarake. Misioni i parë në periudhën 7 korrik 2012 deri në 22 janar 2013, në Kabul në NTM-A (NATO Training Mission-Afghanistan), ishte koha kur ndryshoi rrënjësisht edhe vizioni im mbi rolin e ushtarakëve. Një shkollë e re më vete dhe një eksperiencë që më rriti profesionalisht si ushtarake. Puna dhe bashkëpunimi me stafet shumëkombëshe më ndihmoi të mësoj dhe të përfitoj një eksperiencë shumë të mirë që do të shërbeje edhe më vonë në karrierën time. Gjatë 6 muajve si pjesë e një

shtator 2016-mars 2017, ishte normale të dëgjoja "The Albanian Major", majorja shqiptare. Në këtë fazë e dija shumë mirëëndësinë e këtij emërtimi. Në këtë periudhë shërbeva në Komandën e Veriut të NATO-s, në Mazar el Sharif, në kuadrin e RSM (Resolute Support Mission). Misioni i dytë paqeruajtës, më ndihmoi të hedh themele edhe më solide mbi mënyrën e organizimit të punës në zonat operacionale të NATO-s dhe mënyrën e të punuarit në shtabe shumëkombëshe. Në të dyja këto misione, ja kam arritur t'i përmbyll me sukses në saj edhe të bashkëpunimit dhe mbështetjes të kolegëve të mi shqiptarë. Prandaj për mua të gjithë bashkëudhëtarët tanë në uniformë, janë njerëzit e thjeshtë por të sakrificës. Janë njerëzit që punojnë në heshtje,



stafi profesionist ushtarakësh të pregatitur për operacione kombëtare, me forca amerikane, kanadeze dhe atyre vendase, mësova dhe e ndjeva se sa e rëndësishme është të përfaqësosh denjësisht vendin dhe flamurin tonë kombëtar. Ishte detyrë dhe përgjegjësi shumë e madhe dhe në pozicione të tilla detyra merr vlerë të shumëfishuar. Emri yt atje humbet nën uniformë dhe zmadhohet dhe merr përmasa njerëzore flamuri dhe kombi që përfaqëson. Askush nuk më thërriste në emër, por thjesht "The Albanian Captain", kapitenia shqiptare. Jua siguroj, se pesha dhe barra e kësaj përgjegjësie rëndonte shumë mbi shpatulla. Në misionin e dytë në

pa dallim gjinie, janë ata që ecin përpara, përballojnë çdo sfidë pa u ankuar, ata janë edhe heronjtë e vegjël që shumë pak i njohin por që kanë një vlerë të madhe dhe të patjetërsueshme.

**Gjatë një ceremonie të organizuar më 25 nëntor 2014 në Ministrinë e Mbrojtjes, në prag të 70 vjetorit të çlirimit, për shpërblimin e personaliteteve me "Medaljen e Mirënjohjes" dhe "Medalje Nderi" për shërbime të jashtëzakonshme gjatë kohës së luftës, juve, që atëhere mbanit gradën kapiten, ministri i Mbrojtjes ju vlerësoi me "Medaljen e Mirënjohjes". Sa e rëndësishme**



## është kjo për ju?

Ishte një vlerësim i madh dhe u ndjeva e privilegjuar dhe e nderuar. Realisht jam shumë mirënjohëse për të gjitha mundësitë që më janë ofruar. Ndiem shumë e vlerësuar për mirëbesimin që eprorët dhe kolegët e mi kanë pasur tek unë. Të gjitha këto eksperiencë të fituara në vite janë edhe si rezultat i mundësive që më janë ofruar. Përballë këtyre mundësive, gjithmonë vihesh edhe para përgjegjësisë që të punoj më fort dhe të jap më të mirën time për ta realizuar me sukses përbushjen e misionit tonë si ushtarakë.

**Ju jeni një nga tre oficerët e rinj të diplomuar, me diploma masteri, në fushën e studimeve strategjike në SHBA, në korrik 2020, ku përfunduat kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Leavenworth, Kansas. Diçka rreth studimeve atje, sa kohë zgjati ky kurs?**

Studimet në SHBA ishin një dritare e madhe drejt botës së pafundme të dijes dhe njëmundësi unikalë për rritjen profesionale si ushtarake por edhe në sferën akademike. Një udhëtim shumë sfidues, shumë kërkues por edhe një burim i madh përfitimi njohurish. Studimet i nisa në prill të vitit 2019 dhe i përfundova në qershor të vitit 2021. Faza e parë për një periudhë 3 mujore, mora pjesë në kursin për "Përgatitjen e Edukimit Ushtarak Profesional në "Institutin e Mbrojtjes së Gjuhës në Qendrën e Gjuhës Angleze" DLI në Bazën Forcave Ajrore në Lackland, Texas. Në fazën e dytë zhvillova "Kursin e Komandës dhe Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm" në Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Fort Leavenworth, Kansas. Gjithashtu pata fatin dhe mundësinë të ndiqja studimet në "Masterin e Shkencave dhe Artit Ushtarak, në fushën e studimeve strategjike.

**Sa ndikoi ky arsimim, në një nga akademitë ushtarake më elitare të SHBA-së, tek ju si**

**oficere re por dhe për FA-në? Sa domethënëse është për karrierën e një ushtaraku të studiojë në SHBA?**

Kjo periudhë edukimi në SHBA mëndihmoi që të kuptoj dhe të jem në gjendje të aplikoj më mirë doktrinën ushtarake dhe të rris aftësinë e të punuarit në grup dhe në stafe shumëkombëshe. Mësova shumë mbi operacionet ushtarake, taktikat, strategjinë, lidhshëpin, historinë ushtarake dhe subjekte të tjera që janë të nevojshme për të kompletuar njohuritë që duhet të ketë një oficer karriere që të jetë edhe i aftë të punojë në detyra të ndryshme në kuadër të NATO-s por edhe të angazhimeve të tjera të FARSH. Akademia ushtarake në SHBA më ndihmoi që të thelloj aftësitë e mia analitike për zgjidhjen e problematikave të ndryshme në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Mësimet e marra në fushën e mendimit kritik dhe lidhshëpit ishin shumë me vlerë për të kuptuar rëndësinë e komandimit efektiv dhe rolin e veçantë që kishte efektiviteti i punës në grup. Studimet master për fushën e strategjisë më dhanë mundësinë që të punoj me një staf akademik profesional që më ndihmoi të hidhja baza solide mbi punën kërkimore dhe aplikimin e koncepteve strategjike. Një eksperiencë që më shërben edhe në detyrën time aktuale në fushën e mësimdhënies në AFA. Të gjitha këto njohuri janë një vlerë e shtuar sepse ndihmojnë çdo ushtarak në shërbim të FARSH që t'i vendosë në praktikë, në detyrat e të ardhmes ku do të duhet të shërbejë në kuadër të NATO-s apo edhe OKB-së sipas kërkesave dhe nevojave të FARSH-it.

**Majore Enkelejda, mendon se është e vështirë të punosh në një ambient ku mbizotërojnë burrat, ndjehet e paragjykuar një femër, si është kjo në aspektin gjinor?**

Shpesh në këndvështrimin e përgjithshëm, profesione të caktuara shikohen si domeine të njëjës apo tjetrës gjini. Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura sigurisht nuk është e thjeshtë,

kërkon shumë punë, përkushtim dhe disiplinë të hekurt, por nuk është e paarritshme. Vitet e gjata në shërbim të bëjnë të kuptosh rëndësinë e profesionit por edhe të kolektivit dhe bashkëpunorëve tanë. Respekti fitohet me shumë punë, përkushtim dhe vite të gjata përvojë. Gjatë shumë viteve ku na duhet të përballojmë sfida të përbashkëta në shërbime dhe misione të vështira që të gjithë ne ushtarakët aktivë nën uniformë, bëhemi pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura. Të gjithë bashkë kemi një mision të përbashkët dhe i shërbejmë kombit tonë, dhe objektivi madhor është që ta realizojmë mision tonë me sukses dhe në standarte profesionale. Duke e bërë këtë analizë, në përfundim më duket se ka shumë pak vend për ide ku duhet të ekzistojë paragjykimi për shkak të gjinisë.

**Çfarë do t'ju thonit oficerëve/ushtarakëve të rinj, si në aspektin profesional duke qënë pedagogia e tyre, por edhe atë personal, çfarë do të këshillonit ju për ta?**

Duajeni profesionin tuaj, bëjeni atë pjesë të jetës tuaj dhe jepni më të mirën nga vetja. Mos reshtni asnjëherë së punuari, së eksploruari çdo mundësi dhe eksperiencë të re që do t'ju ofrohet nga shërbimi në FARSH. Qëndroni mendjehapur për të mësuar dhe mos reshtni kurrë së kërkuari dije, sepse është e sigurt që do t'ju udhëheqë në një rrugëtim fantastik që do t'ju surprizojë se sa shumë mund t'ju ndryshojë dhe zgjerojë botëkëutimin tuaj. Sfidat dhe vështirësitë janë pjesë e profesionit të ushtarakut, por jo më kot ata janë edhe njerzit më të veçantë që transmetojnë vlera unike, për sakrificat dhe kontributin që japin në çdo cep të globit ku detyra i thërret. Ushtarakët ambasadorët e paqes dhe stabilitetit janë ata që e mbajnë flamurin shqiptar dhe transmetojnë vlerat më fisnike shqiptare kudo që shkojnë. Mos reshtni së treguari vlerat e profesionit dhe të kombit që përfaqësoni.

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

**S**tërvitja "Defender Europe 21" ku do të marrin pjesë rreth 6000 trupa dhe qindra mjete ushtarake nga SHBA, Shqipëria dhe vende të tjera aleate, do të zhvillohet në bazat kryesore ushtarake të vendit tonë gjatë muajit maj deri në ditët e para të muajit qershor 2021. Për këtë qëllim Forcat e Armatosura shqiptare, në të gjitha strukturat pjesëmarrëse, po vazhdojnë përgatitjet dhe trajnimet për të siguruar realizimin me sukses të stërvitjes. "Defender Europe 21", është edhe një prej stërvitjeve më të mëdha të ushtrisë amerikane në Evropë.

"Angazhimi për zhvillimin me sukses të kësaj stërvitjeje në territorin tonë është jo vetëm një angazhim ushtarak dhe politik por edhe një moment i rëndësishëm për qytetarët e këtij vendi. Shqipëria si vend aleat në NATO, ndihet e nderuar dhe shumë e vlerësuar për faktin se i është besuar detyra e vendit mikpritës për një nga stërvitjet më të mëdha ushtarake të SHBA në Ballkan dhe në Evropën Veriore e Qendrore", do të shprehej ministri Peleshi gjatë vizitës në MM të zëvendëskomandantit të Ushtrisë amerikane në Evropë dhe Afrikë, gjeneralmajor Joseph F. Jarrard. Intervistuar kolonel Razie Mehmeti, drejtor i J-9, për të mësuar rreth përgatitjeve dhe trajnimit që po zhvillohet aktualisht në bashkëpunim me ekipin amerikan, me qëllim mbarëvajtjen e stërvitjes.

**Kolonel Razie Mehmeti, këtë javë keni filluar trajnimin me ekipin amerikan të marrëdhënieve civile lidhur me pjesëmarrjen tuaj në stërvitjen "Defender Europe 21", por dhe nga ana tjetër Qendra e Koordinimit Shumëkombësh e BCU-së, në stërvitje do të bashkëdrejtohet nga stafi i Bashkëpunimit Civilo Ushtarak Shqiptar. Çfarë do të thotë kjo për ju?**

# "Defender Europe 21": Sfidë profesionale dhe besimi për FA të RSH

*Intervistë me Kolonel Razie MEHMETI, Drejtori i J-9 në Shtabin e Përgjithshëm të FA*



Gjatë muajit maj deri javën e parë të qershorit 2021 Shqipëria do të shndërrohet në një pikë strategjike globale, pasi këtu do të ketë pjesëmarrje me rreth 6 mijë trupa të ushtrisë amerikane për të marrë pjesë në stërvitjen e koduar "Defender Europe 21". Kjo stërvitje drejtohet nga komanda e ushtrisë amerikane në Evropë. NATO dhe partneri ynë strategjik SHBA janë shumë të rëndësishme për Shqipërinë dhe Ball-

kanin. Në këtë stërvitje do të ketë një pjesëmarrje nga 26 vende aleate, por ajo që vlen për tu theksuar është aktivizimi i Qendres Shumëkombëshe e BCU-së, me pjesëmarrjen e 17 shteteve dhe e bashkëdrejtuar nga stafi i Bashkëpunimit Civilo Ushtarak Shqiptar. Shqipëria do të jetë vendi mikpritës i stërvitjes me trupa të ushtrisë amerikane "Defender Europe 21", e cila që nga viti 1995, konsiderohet si një nga më të mëd-

hatë në Europë. Kjo ka për qëllim rritjen e aftësisë ndërvepruese mes strukturave ushtarake të vendeve të ndryshme aleate dhe forcimin e paqes, stabilitetit e sigurisë në rajon e më gjerë.

### **Më konkretisht ku do të përqendrohet zhvillimi i stërvitjes?**

Stërvitja "Defender Europe 21" ku do të marrin pjesë rreth 6000 trupa dhe qindra mjete ushtarake nga SHBA, Shqipëria dhe nga vendet e tjera aleate, do të zhvillohet në bazat kryesore ushtarake të vendit tonë. Zhvillimi i stërvitjes është jo vetëm një sfidë por edhe një përgjegjësi e madhe për ne ushtarakët shqiptarë. Stërvitja që do të zhvillohet do të shtrihet në disa vende të Ballkanit dhe të Detit të Zi. Për vendin tonë, Porti Detar Durrës do të jetë një nyje e rëndësishme logjistike për stërvitjen e "Defender Europe 21". Anijet ushtarake do të transportojnë logjistikën e pajisjet luftarake të domosdoshme për stërvitjen në Shqipëri përmes Portit të Durrësit, ku pjesa më e madhe do të vendosen në Shqipëri dhe një pjesë e tyre do të zhvendoset në vendet fqinje. Kjo përforcon rëndësinë strategjike të gjeografisë së Shqipërisë për aleancën e NATO-s.

**Gjatë vizitës së tij në vendin tonë gjeneralmajor Joseph Jarrard, përfaqësues i lartë i Ushtrisë së SHBA në Evropë, tha se Shqipëria është partnere strategjike e sigurisë amerikane në Europë dhe se kjo stërvitje do të shërbejë për ndërveprimin ushtarak të SHBA, me ushtaraket shqiptarë. Cili është roli juaj në këtë stërvitje?**

Po. Gjatë vizitës së realizuar nga ushtaraku i lartë amerikan, gjeneralmajor Joseph Jarrard, Zëvendëskomandant i Ushtrisë së SHBA në Evropë, ai e cilësoi Shqipërinë partnere strategjike e sigurisë amerikane në Europë. Ai theksoi, se stërvitja në fjalë do të shërbejë "për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ushtarak të SHBA, me ushtaraket shqiptarë në tokën shqiptare".

Nisur nga procesi i planifikimit,

Bashkëpunimi Civilo Ushtarak (BCU) i Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe përfaqësues të BCU së Komandës Amerikane në Europë, zhvilluan vizita e takime koordinative, sipas rajoneve të dislokimit apo rajonet stërvitore të vendit, ku është parashikuar të zhvillohet stërvitja "Defender Europe 2021". BCU-ja është angazhuar me strukturat e BCU-së së komandave, për të realizuar një sërë aktivitete duke bashkërenduar ngushtë me Zyrën e Bashkëpunimit Amerikan në Shqipëri (ODC) dhe autoritetet civile. Pra, kemi realizuar një plan koordinimi me strukturat e qeverisjes vendore e lokale, organizatat qeveritare e joqeveritare, ku ekipi i Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak (BCU) i FA-së, drejtuar nga Drejtorja e BCU-së në SHPFA, së bashku me Ekipin Amerikan (Public Affairs Team) zhvilluan takime koordinative me përfaqësues të pushtetit vendor në interes të stërvitjes "Defender Europe 21".



Stërvitja "Defender Europe 21" ku do të marrin pjesë rreth 6000 trupa dhe qindra mjete ushtarake nga SHBA, Shqipëria dhe nga vendet e tjera aleate, do të zhvillohet në bazat kryesore ushtarake të vendit tonë. Zhvillimi i stërvitjes është jo vetëm një sfidë por edhe një përgjegjësi e madhe për ne ushtarakët shqiptarë.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte koordinimi i të gjithë veprimtarive civilo-ushtarake gjatë periudhës së stërvitjes, në interes të mbështetjes së saj me elementë të BCU (CIMIC), Çështjet Publike (Public Affairs) dhe aktiviteteve kulturore.

**Si ishte bashkëpunimi me strukturat vendore në rajonet ku do të ketë prezencë të trupave ushtarake, si do të veprohet?**

Gjatë takimeve koordinative në bashkitë Tiranë, Durrës, Kuçovë, Vlorë, u vlerësua angazhimi dhe pjesëmarrja e bashkive, duke u da-

kortësuar në parim mbi aktivitetet e përbashkëta të forcës ushtarake (Shqiptaro-Amerikane) dhe Autoritetet Civile. Realizimi i koordinimit u vlerësua si nga pala amerikane, ashtu edhe nga autoritetet e qeverisjes vendore e lokale, si domosdoshmëri koordinimi midis strukturave ushtarake me autoritetet civile në terren, kryesisht në rajonet ku do të ketë prezencë të trupave ushtarake. Ekipi i koordinimit i kryesuar nga Drejtorja e BCU në SHPFA, me përfaqësues nga BCU-ve të komandave kryesore sipas zonave të përgjegjësisë, si dhe përfaqësues të Detashmentit CIMIC, gjatë takimeve të tyre kishin në fokus impaktin e strukturave ushtarake në rajone të ndryshme, realizimin e ditëve të hapura, si dhe realizimin e koordinimit sa më efektiv me autoritetet civile dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve kulturore në nivel bashkie. Këto aktivitete do të realizohen duke bashkëpunuar e

koordinuar ndërmjet ekipit koordinues të BCU-së shqiptaro-amerikan. Meqenëse Shqipëria do të ketë një rol të rëndësishëm në këtë stërvitje madhore ushtarake, ajo do të jetë vendi pritës për veprimtaritë e shumta ushtarake dhe kjo përforcon rëndësinë strategjike të gjeografisë së Shqipërisë në rajon.

Në punën time një rol të rëndësishëm kanë luajtur e po luajnë N/kolonel Alda Sula, Major Orges Baholli, Major ® Arben Mollaj dhe N/kolonel Ylli Bajo nga Detashmenti CIMIC e N/kolonele Hatixhe Kola. Ku spikat më tepër elementi femër i angazhuar në personelin e BCU.



Gjithashtu kemi realizuar një bashkëpunim shumë të frytshëm me Sektorin e Komunikimit Strategjik në MM, Këshilltarin e Medias në MM, si dhe QKMBM.

### **Ndërkohë ju po trajnoheni për mbarëvajtjen e kësaj stërvitje. Sa do të jetë koha e trajnimit dhe ku konsiston trajnimi kryesisht?**

Aktualisht, jemi në fazën e trajnimit 2-javor të ekipit BCU-së, pjesëmarrës në stërvitje, personel i dedikuar në interes të kësaj stërvitje. Trajnimi i këtij personeli, drejtuar nga një ekip amerikan i marëdhënive civile (Civil Affairs), ka për qëllim familjarizimin me procedurat, teknikat dhe praktikat gjatë procesit stërvitor, duke përfshirë këtu, parapërgatitjen e ekipit BCU së vendit tonë si pjesë e Qendrës së Koordinimit Shumëkombësh BCU (MNCC-Multinational CIMIC Center), si dhe elementet e BCU në të gjitha rajonet e dislokimit. Ky trajnim mbështetet e monitorohet nga BCU e SHPFA, dhe realizohet me të gjithë personelin e strukturave të CIMIC. Ky trajnim është ndarë në dy pjesë: javën e parë do të trajtohen materiale teorike mbi CIMIC, kryesisht: Familjarizimi mbi çështje e BCU sipas NATO-s; Kapacitetet e BCU nga ushtria amerikane; Krahasimi i BCU me CA (Marredhëniet civile); Planizimi në fushën e BCU; Koordinator apo nderlidhësi në fushën e BCU; Puna e BCU në nivel taktik; BCU-ja në takimet me autoritete civile në tre nivelet: strategjike, operacionale e taktike; Përfshirja e BCU në aspektet e tjera, etj. Këto ditë u trajtuan edhe çështjet rreth medias dhe informacionit publik në FA. Krahas pjesës teorike për dhënien e njohurive bazë në këtë fushë, u kalua në veprime konkrete praktike (punë në grup). Në këtë seancë pjesëmarrësit u njohën dhe vepruan konkretisht me mënyrën e dhënies së intervistës (deri tek mënyrat dhe rrugët e dhënies së tij). Vëmendje e veçantë ju kushtua ezaurimit të problematikave të hasura gjatë punës së deritanishme në këtë drejtim.

### **Kush është fokusi?**

Gjatë trajnimit fokusimi do të jetë në marrjen e njohurive kryesore të punës në BCU, ku pjesëmarrësit do të njohën gjerësisht me Doktrinën e BCU, manualët dhe udhëzimet, konceptet dhe dokumentet e nevojshme që i nevojiten një oficeri të BCU-së për tu familjarizuar dhe vepruar aktivisht në role të ndryshme të funksioneve të BCU-së. Me rëndësi të veçantë po trajtohet roli dhe vendi që BCU luan në mjedisin e operacioneve shumëkombëshe të udhëhequra nga NATO, BE, OKB, etj. Përveç prezantimeve të përgatitura ekipi amerikan dhe në nga J9 trajtuam mbi "Misionit, detyrat, komandim kontrollin dhe pjesëmarrje në operacione të ndryshme humanitare". Javën e dytë do të realizohen praktikisht takimet koordinative me autoritete civile. Meqenëse fokusi e vëmendja kryesore do të jetë Porti i Durrës, nisur nga planifikimi i përbashkët i BCU në SHPFA dhe ODC do të vijohet me takime koordinative konkrete me këto autoritete. Kjo do të startoj me takimet me drejtues nga prefektura e qarkut Durrës, bashkia Durrës, Autoritete Portuale, Policia e Rendit dhe ajo e Kufirit, Shëndetësia, Dogana e Agjensitë Doganore Durrës, Agjensia Kombëtare e Mjedisit, Emergjencat Civile në prefekturë e bashki, etj.

### **Vendi ynë gjatë dy viteve të fundit është përballur me fatkeqësi natyrore siç ishte tërmeti në 2019, apo dhe situata globale e pandemisë 2020, e në vazhdim. Por si do të veprohet në zonat e stërvitjes dhe duke pasur parasysh edhe protokollet e OBSH-së në këtë rast, diçka më tepër?**

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të demonstrojnë kapacitetet e vendit pritës, koordinuese dhe mbështetëse, të një stërvitje në shkallë të gjerë dhe komplekse, si dhe trajnimi për të gjithë komponentët dhe shërbimet, në stërvitje të përbashkëta dhe rajone të ndryshme. Ndërve-

prueshmëria me forcat aleate, duke shfrytëzuar kapacitetet, përgatitja dhe procedurat, për të operuar së bashku me forcat e vendeve të tjera të NATO s apo edhe midis forcave të ndryshme janë objektivat tona.

Në vijimësi jemi angazhuar për mundësimin e përfshirjes së elementëve BCU gjatë stërvitjes. Koordinimi me autoritetet dhe aktorët civilë (kryetarët e bashkive, komunave, OJQ, ON) që veprojnë në zonat e stërvitjes, përfshirja e të gjithë elementëve dhe projekteve të BCU-së dhe politikave të Informimit Publik, kanë qenë fokusi kryesor i punës, në kuadër të mirëkordinimit e planëzimit të detyrimeve të ndërsjellta, sipas fushave: Parapërgatitja e mjedisit civil; Koordinim dhe takime me autoritetet civile; Realizimi i aktiviteteve; Ngritja e Qendrës BCU-Multinational CIMIC Center; Ngritja e Zyrës së Informimit Publik; Aktivizimi i BCU-së shqiptare në varësi të detyrave të CIMIC/Public Affairs

Të gjitha takimet përcaktojnë mirë rolin e BCU-së dhe mbështetjen për realizimin e disa aktiviteteve kryesore, si: Realizimin e fushatave marketing në funksion të impaktit dhe prezencës ushtarake për zhvillimin e stërvitjes; Realizimin e projekteve të BCU-së; Realizimi i shoqërimit për konvojet (Liasion Officer) me oficerë të BCU-së; Realizimin e vizitave mjekësore me stafe të përbashkëta ushtarake e civile dhe OJQ; Realizimin e mësimeve treguese në disa shkolla/komunitet civil, në zonat e stërvitjes-optional. Në fokus do të jenë mënyrat e reagimit të civilëve në rast tërmeti, si dhe marrja e masave parandaluese për situatën e pandemisë në bashkëpunim me OJQ.

Një nga pikat kryesore që është zbatuar e do të vijojë gjatë stërvitjes është respektimi i protokolleve më të mira shëndetësore, bazuar në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për parandalimin dhe përhapjen e virusit "COVID 19". Aktivitetet në përgatitjen dhe zbatimin e ushtrimit do të jenë në përputhje me konceptin e mbështetjes së vendit pritës (Host Nation Support).

## Ekspierencë unike në strukturë dhe ekspertizë

*Intervistë me kolonele Vehbije Kuti, përgjegjëse sektori/zv Drejtor, në Drejtorinë J 5/8 në SHP të FA-së*

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

**K**olonele Vehbije Kuti, aktualisht me detyrë përgjegjëse sektori & z/vdrejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, prej një periudhe 1 vjeçare, nga nëntori i vitit 2019 e deri në nëntor të vitit 2020, ka qenë e emëruar në KFOR, me detyrë Asistente e Shefit të Shtabit për mbështetjen.

KFOR është forca paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO në Kosovë, ku operacionet e saj gradualisht po zvogëlohen derisa Forca e Sigurisë së Kosovës, e themeluar në 2009, "të bëhet e mjaftueshme për veten". KFOR hyri në Kosovë më 11 qershor 1999, pikërisht dy ditë pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kur Kosova po përballlej me një krizë të rëndë humanitare dhe jo vetëm. Gati një milion njerëz ishin larguar nga Kosova si refugjatë, shumë prej të cilëve nuk u kthyen përgjithmonë. KFOR gradualisht po transferon përgjegjësitë tek Policia e Kosovës dhe autoritetet e tjera lokale. Aktualisht, 28 shtete kontribuojnë në KFOR, me një forcë të kombinuar prej më shumë se 3,500 të personelit ushtarak dhe civil. E intervistuar kolonele Vehbije Kutin pas kthimit të saj nga misioni, për të mësuar më shumë rreth



pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të FA-së në KFOR.

**Kolonele Vehbije Kuti, keni vetëm pak kohë që jeni kthyer nga misioni i KFOR-it në Kosovë, si përfaqësuese e FA të RSH. Diçka rreth misionit, përfaqësimit tuaj, si e pritët emërimin? Sa zgjati misioni juaj?**

KFOR është një forcë paqeruajtëse, e drejtuar nga NATO, misioni i së cilës është ruajtja e një mjedisit të sigurtë, liria e lëvizja si dhe lehtësimi i integritetit Euro-Atlantik

i Ballkanit Perëndimor, misioni i cili buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Pjesë e këtij kontributi janë edhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Në Vitin 2019 (në nëntor) për një periudhë 1 vjeçare, m'u dha mundësia të jem pjesë e kësaj strukture, në pozicionin e Asistentes së Shefit të Shtabit për Mbështetjen (ACOS SPT) dhe të jap kontributin tim në interes të realizimit të misionit. Emërimi në këtë pozicion ka qenë një moment mjaft i rëndësishëm dhe një ekspierencë unike. Është pozicioni më i lartë që vendi ynë ka në KFOR.

## Si funksionon KFOR? Cila është struktura e tij?

Mjedisi operational në Kosovë ka ndryshuar ndjeshëm në 20 vitet e fundit dhe do të vazhdojë të ndryshojë edhe në të ardhmen. KFOR në mënyrë konstante ka përshtatur rolin dhe strukturën e tij me qëllim përbaljen me sfidat në mënyrë sa më efektive në interes të sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë. Ndryshimi i fundit në strukturën organizative të KFOR-it është ai i gushtit të vitit 2019, në të cilin kemi Grupin e Mbështetjes të Shtabit (HSG) dhe Grupin e Përbashkët të Mbështetjes Logjistike (JLSG) në Camp Film City, dy komandat rajonale, atë lindore dhe perëndimore, respektivisht RCE-E në kamp Bondsteel dhe RCE në Camp Villaggio Italian me seli në Camp Villaggio Italia, Njësia e Specializuar Shumëkombëshe (MSU), në Prishtinë, Batalioni i Rezervës Taktike të KFOR-it (KTRBN), në Kampin Novo Selo.

## Po detyra juaj cila ishte më konkretisht në këtë mision?

Ashtu siç e theksova edhe më lart, detyra ime ka qenë ajo e Asistentes së Shefit të Shtabit për Mbështetjen (ACOS SPT). Mbështetja (SPT) është një nga shtatë degët në strukturën organike të KFOR-it dhe e vetmja me tre drejtori vartëse, respektivisht J1, J4 dhe Infrastrukturë e xhenio. Me pak fjalë, unike si në strukturë ashtu edhe në ekspertizë. Një nga detyrat kryesore e ACOS SPT, ishte raportimi të Shefi i Shtabit të KFOR-it dhe ekzekutimi i autoritetit koordinues nëpërmjet Shefit të Shtabit dhe Komandantit të KFOR-it për çështje që lidhen me mbështetjen. Kam kryer edhe detyrën e Shefit të Shtabit në mungesë të këtij të fundit.

ACOS SPT është përgjegjës për Drejtimin dhe koordinimin e aktiviteteve dhe detyrave me drejtoritë vartëse J1, J4 dhe Infrastrukturë e xhenio, për planifikimin e politikave të personelit, mbështetjen logjistike, mbështetjen me Infrastrukturë si dhe koordinimin e aktiviteteve. Misioni i SPT mund të përshkruhet me tre fjalë, 1. Planifikimi, 2. Sigurimi dhe 3. Koordinimi.

Përveç sa më sipër kam qenë drejtuese e bordit të rishikimit të kërkesave në Investime dhe Infrastrukturë. Gjithashtu kam drejtuar edhe takimin koordinues me Ko-

mandantin e Grupit të mbështetjes Logjistike (JLSG), Komandantin e Grupit të mbështetjes të Shtabit (HSG), ACOS J8, J6 dhe këshilltarin mjekësor. Eksperienca ime e punës në shtab dhe për më tepër në Drejtorinë e J5/8 si dhe në Perfaqësinë Ushtarake të RSH në NATO si Oficer Shtabi përgjegjës për logjistikën, personelin dhe pajisjet kanë bërë të mundur që performanca dhe kontributi i dhënë në KFOR të ketë qenë një vlerë e shtuar. Ky kontribut dhe ekspertiza janë pasqyruar edhe në vlerësimin e bërë si nga Shefi i Shtabit ashtu edhe nga Komandanti i KFOR-it.

## Si është aktualisht situata e sigurisë në Kosovë, nën KFOR, parë me syrin e një ushtarakeje karriere si ju? Si ka evoluar ajo?

Aktualisht situata e sigurisë në Kosovë është e përmirësuar dhe vazhdon të mbetet e qetë dhe e qëndrueshme por ka edhe disa faktorë që e bëjnë situatën

## Po situata në veri të Kosovës, si paraqitet?

Siç theksova edhe më lart, situata e sigurisë në Kosovë është e qetë, e qëndrueshme por e brishtë kjo ka bërë që KFOR të ketë një prezencë të trupave në veri të cilat monitorojnë situatën në mënyrë të vazhdueshme.

## Dhe së fundi si ka qenë të jesh femër pjesëmarrëse në mision, përfaqësuese e FA-së, por dhe në një post të rëndësishëm si ky i yti?

Të qenit femër nuk ka qenë aspak pengese, përkundrazi, jam ndjerë e barabartë në mes të barabartëve. Operacionet/misionet ushtarake në ditët e sotme kërkojnë diversitetet kualifikimesh, burimesh dhe përfaqësimi. Krahas detyrës si ACOS SPT, duke qenë edhe ushtarake me Gradën më të lartë kam qenë edhe Përfaqësuese e Lartë Kombëtare. Ju jam mirënjohëse djemve dhe vajzave



të jetë e brishtë. Si rezultat, më 11-12 qershor 2009, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s vendosën të rregullojnë gradualisht qëndrimin e forcës së KFOR-it drejt asaj që quhet "deterance presence". Në kulmin e tij, trupat e KFOR-it përbëheshin nga 50,000 burra dhe gra nga 39 vende të ndryshme të NATO-s dhe jo-NATO-s nën komandë dhe kontroll të unifikuar. KFOR po bën gradualisht transferimin e përgjegjësive drejt policisë së Kosovës dhe autoriteteve të tjera lokale. Aktualisht në KFOR japin kontributin e tyre 27 vende me më shumë se 3500 përfaqësues, personel ushtarak dhe civil.

me uniformë që kanë shërbyer në të njëjtën periudhë me mua në KFOR, për korrektësinë, përkushtimin dhe performancën e treguar. Në përbushjen me sukses të kësaj detyre kam patur mbështetjen e pakursyer nga i gjithë zinxhiri i komandimit në FA, duke filluar me Përfaqësuesin e Lartë Ushtarak të RSH-së në SHAPE ashtu edhe të drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm dhe ato në MM. Nuk mund të lë pa përmendur edhe mbështetjen e Ambasadorit të RSH në Kosovë, zotit Qemal Minxhozi, i cili vazhdimisht ka qenë i pranishëm në të gjitha aktivitetet e zhvilluara si nga Komandanti i KFOR-it, ashtu edhe ato kombëtare.



# Homazh për Kapiten Feti Vogli, akti i tij heroik na mbush me krenari

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj, përcjell, më 20 shkurt 2021, një mesazh për 9-vjetorin e rënies në krye të detyrës të Dëshmorit të Atdheut, Kapiten Feti Vogli.

Mesazhi si më poshtë:

"Data 20 shkurt 2012, sjell një kujtesë të dhimbshme për Forcat tona të Armatosura. Në këtë ditë të pafat humbi jetën kolegu ynë i shtrenjtë, Kapiten Feti Vogli. Prandaj ky mesazh sot është një homazh në përkujtim të 9-vjetorit të rënies në krye të detyrës të një ushtaraku me kontribute, vlera dhe veti të larta. Kapiten Feti Vogli, me shpirtin e sakrificës dhe me aktin e madh heroik që kreu na mbush të gjithëve me krenari.

Kjo krenari ka të bëjë me atë që ushtarakët kryejnë çdo ditë: përmbushjen e misionit kushtetues dhe atij human, kurdoherë dhe kudo që ata ndodhen, brenda dhe jashtë vendit. Ushtarakët si Feti, kryejnë një mision që s'ka të krahasuar me atë të profesioneve të tjera, ata mbrojnë dhe kontribuojnë për atdheun, sigurinë, lirinë dhe paqen, deri në sakrificën më sublime. Për këtë jemi të gjithë kryelartë, jo vetëm ne ushtarakët, por edhe fëmijët tanë, prindërit, vëllezërit e motrat tona.

Humbja e kolegut tonë të paharruar nuk na ka tërhequr dhe as ndaluar në plotësimin e detyrimeve tona. Ne kemi vazhduar dhe do të vijojmë kontributin dhe investimin

Ushtarakët tanë shërbejnë me krenari dhe ngrenë lart flamurin e Shqipërisë në Afganistan, Kosovë, Letoni, Sudan dhe kudo të jetë e nevojshme



tonë për paqe e stabilitet kudo në botë. Ushtarakët tanë shërbejnë me krenari dhe ngrenë lart flamurin e Shqipërisë në Afganistan, Kosovë, Letoni, Sudan dhe kudo të jetë e nevojshme. Me këto angazhime Forcat tona të Armatosura japin sinjalin dhe provojnë që

ne jemi një anëtar dinjitoz i Aleancës euroatlantike ku bëjmë pjesë.

Kjo është gjithashtu edhe dita e rasti për të rishprehur mirënjohjen e përhershme familjeve të ushtarakëve për rolin dhe kontributin e tyre të pazëvendësueshëm. Ato janë mbështetja më e madhe dhe e fuqishme për çdo ushtarak jo vetëm në misione, por edhe në jetën e përditshme. I përhershëm ngelet edhe detyrimi jonë që të gjendemi pranë për familjet tona - familjet e ushtarakëve."

*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH  
Gjeneralmajor Bajram Begaj*



Kontingjenti i XIII-të paqeruajtës "Resolute Support Mission" Kabul, Afganistan, ka zhvilluar më 20 shkurt një ceremoni përkujtimore pranë memorialit, me rastin e 9-vjetorit të rënies në krye të detyrës së kapiten Feti Voglit, në Afganistan. Trupat tanë që shërbejnë aktualisht në Afganistan nderuan kolegun e tyre në memorialin kush-tuar ushtarakut shqiptar të rënë heroikisht në mbrojtje të vlerave të aleancës sonë. Lavdi përjetë kapiten Feti Voglit", -shkruan Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në facebook. Kapiten Feti Vogli, pjesë e misionit luftarak "Eagle 4", në përbërje të Batalionit të Forcave Speciale BOS në Kandahar të Afganistanit, humbi jetën gjatë misionit të NATO-s në Afganistan. Ishte 20 shkurt i vitit 2012 kur një grup me efektive shqiptarë u godit pabesisht nga një efektive taleban i infiltruar mes trupave afgane duke qëlluar me armë nga ku mbeti i vrarë kapiten Feti Vogli. Kapiten Feti Vogli është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Në Baldushk të Tiranës, ku ishte vendlindja e tij (23 mars 1981), Shkolla e Mesme e Bashkuar mban emrin "Feti Vogli".

Ai mbaroi Akademinë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore. Nga data 1 qershor 2010 kryente detyrën e komandantit të Grupit të Parë Special në kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore. Kapiten Feti Vogli ishte një ushtarak karriere i shkëlqyer dhe si rezultat i arritjeve në detyrë është dekoruar disa herë

## Misioni ynë në Afganistan nderon kujtimin e kapiten Feti Voglit



me medalje të ndryshme si: "Medalja e Karrierës" në vitin 2007 nga komandanti i Forcës së Bashkuar. Medalja për "Shërbime Ndërkombëtare" nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2007." Medalje për shërbime të Shquara" nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2010. Në datën 20 shkurt 2013 për herë të parë, u ul në selinë e NATO-s Flamuri Kombëtar i Republikës së Shqipërisë në gjysmështrizë për humbjen e kapitenit Feti Vogli. Kjo është një traditë që kryhet në respekt të të gjithë ushtarakëve që humbin jetën në misionet ushtarake të drejtuara nga NATO.

Komandanti i Skuadronit të

Dytë të Ushtrisë së SHBA-së që operonte në kuadër të misionit ISAF në Afganistan, me të cilin Forcat Speciale shqiptare kryenin misionin e tyre në Kandahar, Nënkolonel David Jones shprehet ndër të tjera në letrën dërguar familjes së kapitenit Feti Vogli dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura se "kapiteni Feti Vogli ra pre e një zjarri të befasishëm të një efektivi të policisë afgane në pikën e kontrollit, ndërsa ai iu përgjigj këtij zjarri me trimëri e kurajë. Do të ndjejë mungesën e kapitenit Feti Vogli dhe ndikimin e tij pozitiv në mjedisin e luftës në Afganistan".

## Strukturat e Komandës Mbështetëse

Më 20 shkurt 2021, në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale u zhvillua ceremonia e 9-vjetorit të rënies në krye të detyrës të Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli në misionin luftarak "EAGLE 4" Kandahar, Afganistan. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, shefat e degëve, familjarët e dëshmorit, miq dhe shokë.

Fjalën e rastit në këtë ceremoni e mbajti komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i cili ndër të tjera theksoi: "Duke nderuar

## Regjimenti i Operacioneve Speciale kujton Dëshmorin e Atdheut, kapiten Feti Vogli

veprën e kapiten Voglit ne nderojmë familjen e tij, Forcat e Armatosura dhe vendin tonë. Kapiten Vogli ishte dhe do të mbetet një hero, njeri kurajoz dhe do të kujtohet e lartësohet me nderimet më të mëdha, si një luftëtar trim dhe përherë i respektuar. Heroizmi i Tij do të jetë forca, motoja, shpirti ynë dhe si i tillë do të mbetet gjithmonë në mendjet dhe besimin tonë, duke na dhënë

zemër dhe vendosmëri për të ecur përpara në sfidat që na presin, për të qenë të pamposhtur në realizimin dhe përmbushjen e misionit tonë të shenjtë." Në përfundim të fjalës së komandantit të Forcës Tokësore u mbajt një minutë heshtje në kujtim të dëshmorit. Kjo ceremoni u mbyll me vendosjen e kurorave me lule nga familjarët dhe ish-kolegët pranë bustit të dëshmorit.

# Studentët po punojnë online që nga 14 dhjetori 2020

## Mësimdhënia online në Qendrën e Gjuhëve të Huaja të AFA-së

Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja certifikohen rreth 150-200 kursantë të gjuhës angleze në vit dhe rreth 10 kursantë në secilën nga gjuhët e dyta. Programi përmban kurs të gjuhës angleze, gjermane, frënge, italiane, turke, greke, maqedonase dhe serbe

HAJRIE DEDAJ

**N**jë nga shqetësimet më të mëdha të muajve të fundit është ndikimi i pandemisë Covid-19 në arsim. Për të parë sesi është duke u zhvilluar mësimi, sesi po ndiqen leksionet, platformat që po përdoren vizituar ambientet e Qendrës së Gjuhëve të Huaja të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Njohja dhe përdorimi i gjuhëve të huaja është thelbësor në procesin e integritetit dhe detyrim kryesor, si vend anëtar i Aleancës. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj është kriter për përparimin e mëtejshëm në gradë dhe karrierë për pjesëtarët e Forcave të Armatosura. Për të kuptuar sesi është duke vijuar mësimdhënia on-

line pamë nga afër realizimin e një ore mësimore nga pedagogia e anglishtes Alma Vladi.

Grupi i cili po zhvillonte mësim ishte "Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm", një grup prej 28 kursantësh, që punonin nëpërmjet platformës "Zoom", e cila ka rezultuar mjaft efektive në realizimin e orëve mësimore. Studentët janë duke punuar online, që prej datës 14 dhjetor 2020 ata janë duke zhvilluar në këtë mënyrë jo vetëm leksionet, por edhe seminarat. Sigurisht që ka pasur ndryshime, pasi tashmë mësimi nuk zhvillohet më në mënyrën e tij klasike, por në një mënyrë të re, që kërkon edhe më shumë mund dhe sakrificë për tu realizuar. Duke marrë parasysh që kursantët, studentët janë ata të cilët u përballën të parët me këto ndryshime, i pyetëm se sa vështirë është të realizohet mësimi online. Njëri prej tyre u përgjigj kështu: "Idealja do të ishte në klasë, por duke marrë para-





sysh situatën në të cilën ndodhemi mësimdhënia online është e vetmja zgjidhje." Por kishte dhe nga ata, që mendonin se për shkak të kushteve jo fort të favorshme që ofron mësimi nga shtëpia, duke qenë se një pjesë e tyre janë familjarë ua vështirëson procesin e mësimnxënies. Pavarësisht kësaj është e vetmja mënyrë, që kursantët të mos ngelen pas në arritjet e tyre mësimore.

Në një bashkëbisedim me pedagogun Vladi e cila u tregua shumë e gatshme për të bashkëpunuar, ajo na tregoi eksperiencën e saj të mësimdhënies online dhe platformat, që janë duke u përdorur. "Platforma që përdorim më së shumti në Qendrën e Gjuhëve të Huaja është "Zoom", por është edhe një platformë tjetër "files.aaf.mil.al" ku janë të hedhura leksionet, të cilat shfaqen gjatë kohës që është duke u zhvilluar mësimi në ekran, studentët i shohin dhe më pas mund të punojnë me këto materiale. Unë preferoj, që

Pas ndjekjes së kursit, kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet testit përfundimtar, që është testi i nivelit me të cilin kursantët certifikohen. Është një provim i cili përcakton nivelin e gjuhës për personelin ushtarak dhe civil, që do të përfaqësojë vendin tonë në shtabet e NATO-s si dhe në misione të ndryshme, testi bëhet sipas STANAG 6001. Pavarësisht Covid-19 provimet nuk po zhvillohen online, por në klasa duke mbajtur distancën e duhur dhe duke iu përmbajtur rregullave për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Kjo është mënyra më e mirë e vlerësimit për ta.

"Në kurset e gjuhës angleze certifikohen 150-200 kursantë në vit dhe rreth 10 kursantë në secilën nga gjuhët e dyta", - do të shprehej për gazetën "Ushtria" Drejtori i Qendrës së Gjuhëve të Huaja z. Bledi Vrapit. Qëllimi i testimit është, që të vlerësojë nivelin e përgjithshëm të njohurive të

tradicionale, do të preferonin metodën e vjetër të mësimdhënies, atë të prezencës nëpër auditore, megjithatë përshtatja ka sfidat e saj.

Momentalisht orët mësimore të anglishtes zhvillohen në harkun kohor të 50 minutave, 2 ose 3 herë në javë. Për sa i përket kohëzgjatjes së kursit, kjo varet nga niveli i studentit dhe nga grada që ata duan të arrijnë. Kursi i lartë i oficerit ka edhe nivelin më të lartë të gjuhës së huaj. Metoda me të cilën ata punojnë në gjuhën angleze është "American Language Course". Librat me të cilët punojnë kanë tematikë ushtarake, janë botime të huaja të përshtatura për ushtarakë. Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja mësohen disa gjuhë sipas nevojave të FARSH të përcaktuara nga planet vjetore të arsimit që miratohen nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Programi përmban kurs të gjuhës angleze, gjermane, frënge, italiane, turke, greke, maqedonase dhe serbe. Kohëzgjatja e kurseve është në funksion të programeve sipas niveleve, mësimëve të nxjerra si dhe nevojës për t'u përgjigjur proceseve të modernizimit të procedurave. Pjesa më e madhe e kursantëve janë ushtarakë, ky është dhe fokusi në fund të fundit, arsimiti i tyre, por nuk mungojnë as studentët civile. Qendra e Gjuhëve të Huaja është institucioni i vetëm i autorizuar për të hartuar programet mësimore dhe trajnimin e instruktoreve të gjuhës së huaj në forca dhe reparte si dhe për testimin e aftësive në gjuhë të huaj të personelit të FARSH sipas STANAG 6001.

Tre janë elementët kryesorë: objektivat, mësimdhënia dhe vlerësimi, apo kontrolli i dijeve. Këta elementë kombinohen më së miri kur mësimdhënia dhe vlerësimi fokusohen në arritjen e objektivave. Kur sheh se të tri këto elementë janë përmbushur edhe në këtë situatë pandemie, atëherë kupton dhe rezultatet e punës së pedagogëve të Qendrës së Gjuhëve të Huaja dhe dëshirën e mirë të studentëve për t'u formuar në profesionin aq shumë të respektuar të ushtarakut.



Njohja dhe përdorimi i gjuhëve të huaja është thelbësor në procesin e integritetit dhe detyrim kryesor, si vend anëtar i Aleancës. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj është kriter për përparimin e mëtejshëm në gradë dhe karrierë për pjesëtarët e Forcave të Armatosura.

studentët e mi të kenë dhe librin fizikisht, pasi kështu kanë mundësi të mbajnë dhe shënim në të, kontakti me librin në këtë formë është më i mirë. Sigurisht që mësimdhënia online ka sfidat e saj, tashmë për shkak të situatës në të cilën ndodhemi ora mësimore nuk ka në qendër studentin, por pedagogun.

Mësimi në auditor është më komod, e lehtësonte më shumë pjesën e komunikimit sidomos për gjuhët e huaja të cilat kanë fjalët e reja, që duhet ti shkruajmë në tabelë, kështu studentit i mbetet në memorie. Ana vizuale është ajo që ndihmon më së shumti dhe kjo ndikon në përvetësimin e fjalëve të reja", -u shpreh pedagogia Vladi.

gjuhës angleze nga secili kandidat që do ti nënshtrohet. Objektivat e Ministrisë së Mbrojtjes, si vend anëtar i NATO-s kërkojnë nivelet e duhura të aftësisë për të realizuar komunikimin gjuhësor në fushën profesionale. Vlerësimi synon katër aftësi gjuhësore: dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim. Kështu vlerësohet shkalla e aftësisë së kandidatit për të komunikuar në mënyrë efektive në mjediset profesionale, ushtarake dhe sociale. Për sa i përket përshtatjes së pedagogëve me procesin e mësimdhënies online disa prej tyre e kanë pasur më të lehtë të përqafojnë këtë metodë, pasi janë të dhënë pas teknologjisë, kurse një pjesë e tyre, pedagogët

# Stërvitja ushtarake ndërkombëtare “Defender Europe 21” mbërrin në Parlament

Në “Defender Europe 21” marrin pjesë forca aleate dhe partnere si: SHBA, Shqipëria, Kanadaja, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj.

**N**ë këtë stërvitje do të angazhohen 3100 trupa ushtarake të vendeve aleate dhe 960 efektivë të Forcave të Armatosura shqiptare.

Mjetet do të jenë, si më poshtë vijon: 12 helikopterë shumërolësh dhe MEDEVAC; 6 sisteme raketash “Patriot”; 1000 automjete të ndryshme (jo luftimi) transporti mallrash, personeli dhe mjete xheniere; 10 mjete detare: 2 LSV; 2 army MCS; 1 T=EPF; 1 UK point class vessel; 1 navy causeway ferry, si dhe 3 mjete të tjera; Avionë transporti për personelin dhe mallrat. Do të marrin pjesë 25 mjete fluturuese në misionin Astral Knight, pjesë e “Defender Europe 21”: 10 avionë F15; 2 avionë F16; 2 avionë F35 (1 italian, 1 amerikan); 3 avionë tip KC-135, për furnizim në ajër; 7 helikopterë për kërkim-shpëtim dhe 1 avion patrullimi C 130.

Projektligji “Për zhvillimin e pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21” ka mbërritur për miratim në parlament për t’i hapur rrugën stërvitjes më të madhe amerikane dhe vendeve aleate në vendin tonë e cila do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021.

Qëllimi i projektligjit është të lejohet zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate. Në kuadër të bashkëpunimit të



vendeve aleate dhe nën udhëheqjen e palës amerikane do të zhvillohen manovra dhe misione stërvitore për të rritur kapacitetet mbrojtëse dhe bashkëpunimin e forcave të armatosura të secilit vend gjatë operacioneve të përbashkëta. Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në paketën e stërvitjeve “Defender Europe 21”, është demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura, për të pritur, koordinuar dhe për t’u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe të NATO-s, në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks, në poligone, terrene stërvitore. Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për vitin 2021, për Ministrinë e Mbrojtjes.

Kjo stërvitje zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me palën amerikane. Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) do të drejtojë paketën e 2 stërvitjeve të koduar “Defender Europe 21”. Në këtë paketë do të jetë pjesëmarrja e forcave aleate dhe partnere, si: Kanadaja, Bosnjë dhe Hercegovina,

Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj. Zhvillimi i stërvitjes dhe pjesëmarrja e një numri të madh trupash ushtarake në këtë stërvitje do të rrisin bashkëpunimin ndërmjet vendeve. Duke realizuar me sukses angazhimet e marra përsipër në këtë projektligj, vendi ynë tregon se është i aftë të bashkëpunojë e të zhvillojë stërvitje të rëndësishme dhe me numër të madh trupash e mjeteve. Qëllimi i pjesëmarrjes së FARSH-it në paketën e stërvitjeve “Defender Europe 21” është demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për koordinimin, pritjen e forcave amerikane dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për trajnim të përbashkët me palën amerikane në disa disiplina në një aktivitet operacional shumë kompleks. Gjithashtu, synohet të testohen procedurat kombëtare në koordinimin me autoritetet e tjera të vendit për përdorimin e aeroporteve, porteve, hapësirës ajrore dhe detare, procedurat për kalim transit në territorin e vendit tonë,

si dhe procedurat tona kombëtare si Host Nation. Stërvitja "Defender Europe 21" ndahet në disa stërvitje me tematikë më të kufizuar. Forcat Ushtarake të Republikës së Shqipërisë do të marrin pjesë me 960 efektivë në komponentët e mëposhtëm të stërvitjes: 784 efektivë në stërvitjen "Immediate Response 21" (17 maj-2 qershor); 72 efektivë në stërvitjen "Saber Guardian 21" (16 maj-10 qershor); 104 efektivë në stërvitjen "Astral Knight 21" (13 maj-21 maj). Pjesëmarrja e FARSH-it në këtë paketë stërvitjesh ndikon në rritjen e aftësive teknike dhe operacionale të trupave tanë dhe veçanërisht të Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësisë dhe Qendrës së Kontroll-Raportimit të FA-së. Ndërveprueshmëria, integrimi i strukturave tona dhe zhvillimi i aktivitetit të përbashkët stërvitor do të përcjellë mesazhe me impakt strategjik në fushën e bashkëpunimit, sigurisë dhe mbrojtjes. Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë po planëzon të dislokojë në vendin tonë përafërsisht 3100 efektivë për zhvillimin e stërvitjeve të sipërpërmendura. Strukturat dhe elementët e parë të ushtrisë amerikane do të fillojnë të dislokohen në territorin e vendit tonë që në fillim të muajit prill 2021, ku misionet e tyre do të jenë "aktivitetet e informimit" dhe përgatitja e infrastrukturës logjistike për ngritjen e kampeve fushore në të gjitha vendet e dislokimit dhe terrenet stërvitore të ofruara nga FA-ja. Zhvillimi i stërvitjes së përbashkët në kohën e përcaktuar do të jetë një sukses për vendin tonë dhe do të tregojë jo vetëm demonstrimin e seriozitetit me partnerët tanë, por edhe aftësinë e përgatitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për t'iu përgjigjur sfidave të kohës.

Projektligji është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Neni 14, i ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, në pikën 1 të tij, përcakton

se: "1. Vendimi për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitje të përbashkëta ushtarake ndërkombëtare, në veprimtari të organizuara, të autorizuara ose të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Europian apo vendet e tjera, në territorin e Republikës së Shqipërisë, për numër të përgjithshëm pjesëmarrësish, merret: a) deri në 500 veta, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes; b) mbi 500-1000 veta, me vendim të Këshillit të Ministrave; c) mbi 1000 veta, me ligj nga Kuvendi.". Meqenëse në stërvitje do të marrin pjesë 3100 (tre mijë e njëqind) trupa ushtarake, është në kompetencë të Kuvendit marrja e vendimit për zhvillimin e stërvitjes. Për sa i përket përputhshmërisë me nenin 5, të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon: "Ndalimi i përdorimit të forcave dhe strukturave të posaçme. Forcat komando dhe forcat e tjera të ushtrisë ndalohen që të përdoren gjatë gjithë fushatës zgjedhore, përveçse me urdhër me shkrim të ministrit që mbulon rendin publik dhe ministrit të Mbrojtjes, kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësishme të veçantë, në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Shtetit ose në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare. Një kopje e urdhrit me shkrim i dërgohet menjëherë KQZ-së. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet. Forcat e ushtrisë ndalohen të kryejnë ushtrime ose manovra ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit të tyre gjatë gjithë fushatës zgjedhore. Në të gjitha llojet e zgjedhjeve ndalohet përdorimi ose pjesëmarrja e punonjësve apo strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror.", shprehemi se të gjitha veprimet e operacionet paraprake para datës 25.4.2021 do të jenë të një natyre planëzuese dhe logjistike dhe do të zhvillohen brenda reparteve. Edhe nga palët e huaja është marrë garanci që asnjë veprim ose manovër nuk do të zhvillohet jashtë reparteve para datës 25.4.2021. Manovrat e mirëfillta stërvitore do të fillojnë në datat e ilustruara në pjesën e III-të të rela-

cionit, pra, kryesisht në muajin maj. Periudha para këtyre datave është parapërgatitore për të garantuar zhvillimin me sukses të akomodimit, logjistikës dhe zhvillimit të stërvitjes në përgjithësi. Për sa më sipër, miratimi i këtij projektligji nuk cenon asnjë dispozitë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë. Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të Bashkimit Europian.

### **Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit**

Projektligji përbëhet nga 9 (nëntë) nene. Në nenin 1 parashikohet zhvillimi dhe pjesëmarrja e forcave të armatosura të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate (në vijim, trupa aleate), në stërvitjen e përbashkët "Defender Europe 21", në kuadër të bashkëpunimit shumëpalësh. Bazuar në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, kompetenca për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në këtë stërvitje të përbashkët është e Kuvendit, duke qenë se në stërvitje do të marrin pjesë mbi 1000 (një mijë) veta. Stërvitja që po miratohet me këtë projektligj është në kuadër të bashkëpunimit të vendeve aleate në rastin e një agresioni të jashtëm. Kjo stërvitje do të evidentojë kapacitetet e përgjigjes së aleateve dhe lehtësimin e sigurimit të pikave kyçe të mbrojtjes kombëtare, duke mundësuar një transitim sa më të lehtë për trupat aleate. "Defender Europe 21" zhvillohet në të gjitha vendet e Ballkanit dhe garanton bashkëpunimin ndërmjet këtyre vendeve dhe forcave amerikane, të cilat do të mund të vijnë në ndihmë në rast të një agresioni nga një forcë e huaj armike. Siç dihet, mbrojtja kolektive është një koncept i parashikuar nga neni 5, i Traktatit të Atlantikut të Veriut, i nënshkruar në Londër, më 19



qershor 1951, dhe ratifikuar nga ana e Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10100, datë 26.3.2009. Konkretisht, ky koncept shtjellohet në nenin 5, të traktatit, i cili parashikon, sa më poshtë vijon: "Palët bien dakord se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej tyre në Europë apo në Amerikën e Veriut do të quhet si sulm kundër të gjitha atyre dhe si pasojë bien dakord që, nëse ndodh një sulm i tillë, secila nga ato, në ushtrim të së drejtës së vetëmbrojtjes kolektive apo individuale të njohur nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të ndihmojë palën apo palët e sulmuara në këtë mënyrë duke ndërmarrë menjëherë, individualisht dhe në bashkërendim me palët e tjera, ato veprime që i vlerëson si të nevojshme, përfshirë këtu përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur e ruajtur sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut. Çfarëdo sulmi i tillë i armatosur dhe të gjitha masat e marra si rrjedhojë e tij do t'i njoftohen menjëherë Këshillit të Sigurimit. Masa të tilla do të përfundojnë kur Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masat e nevojshme për të rivendosur e ruajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.". Për thjeshtësimin e bashkëveprimit të forcave të armatosura të shteteve të ndryshme anëtare të organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, edhe në raste të tilla, Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë ka propozuar zhvillimin e stërvitjes "Defender Europe 21". Në nenin 2 parashikohet lejimi i hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3100 (tre mijë e njëqind) trupave aleate, pjesëmarrës në stërvitje. Në nenin 3 përcaktohet qëllimi i kësaj stërvitjeje, i cili është realizimi i operacioneve dislokuese nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit, si edhe testimi i infrastrukturës mbrojtëse të vendit tonë në rast të misioneve të mbrojtjes kolektive dhe ndihmës së ndërsjellë të vendeve aleate. Në nenin 4 përcaktohet periudha e zhvillimit të stërvitjes dhe rajonet e zhvillimit të saj. Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet në periudhën 26 prill-20 qershor 2021, në Komandat

e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, në garnizonin "Skënderbej", bazën ajrore të Farkës, bazën ajrore të Kuçovës dhe në poligonet stërvitore të Bizës dhe Fekenit, si dhe në rrugëkalimet ajrore e tokësore për në këto rajone. Gjithashtu, palëve pjesëmarrëse në stërvitje do t'i vihen në dispozicion edhe hapësira detare e ajrore, për shkak se mjetet do të lëvizin në to pa u kufizuar në zonat ushtarake. Në nenin 5 përcaktohet numri i trupave ushtarake dhe i mjeteve që do të përdoren në stërvitje. Në këtë stërvitje do të angazhohen 3100 (tre mijë e njëqind) trupa ushtarake të vendeve aleate. Mjetet do të jenë, si më poshtë vijon: 1. 12 helikopterë shumërolësh dhe MEDEVAC; 2. 6 sisteme raketash "Patriot"; 3. 1000 automjete të ndryshme (jo luftimi) transporti mallrash, personeli dhe mjete xhëniere; 4. 10 mjete detare: 2 LSV; 2 army MCS; 1 T=EPF; 1 UK point class vessel; 1 navy causeaway ferry, si dhe 3 mjete të tjera; 5. Avionë transporti për personelin dhe mallrat; 6. 25 mjete fluturuese që do të marrin pjesë në misionin Astral Knight, pjesë e "Defender Europe 21": a) 10 avionë F15; b) 2 avionë F16; c) 2 avionë F35 (1 italian, 1 amerikan); ç) 3 avionë tip KC-135, për furnizim në ajër; d) 7 helikopterë për kërkim-shpëtim; dh) 1 avion patrullimi C 130. Në nenin 6 përcaktohet statusi që do të kenë trupat aleate që do të vijnë për të marrë pjesë në stërvitje. Këto trupa, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.10101, datë 26.3.2009. Në nenin 7 parashikohet shoqërimi i trupave të vendeve aleate. Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në nenin 8 përcaktohen

organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Do të ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij ligji. Ministritë e tjera, përveç asaj përgjegjëse për mbrojtjen, janë ngarkuar me zbatimin, sepse do të mundësojnë aksesin e trupave dhe përdorimin e infrastrukturave civile për aksesin e trupave dhe të mjeteve. Pra, Ministria e Brendshme, duke qenë përgjegjëse për menaxhimin e kufijve, do duhet të lehtësojë kalimin e trupave dhe mjeteve nëpër pikat e kontrolit kufitar. Ndërsa Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do duhet të vendosë në dispozicion infrastrukturën kritike, si porti i Durrësit dhe aeroporti "Nënë Tereza", si për hyrjen në Shqipëri të trupave, por edhe për përdorimin e tyre nga mjetet e Forcave të Armatosura të vendeve aleate. Në nenin 9 përcaktohet hyrja në fuqi e këtij akti, i cili do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare". Për zbatimin e këtij akti ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Projektligji është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

### **Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore**

Projektligji nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit. Për sa u përket kostove financiare që mbart zhvillimi i këtyre stërvitjeve, FARSH-i ka për detyrim vendosjen në dispozicion të infrastrukturës stërvitore, mjetet tokësore, detare dhe ajrore. Shpenzimet për palën amerikane dhe vendet e tjera pjesëmarrëse, të cilat do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë do të mbulohen nga vetë palët. Pala jonë ka detyrimin për mbulimin e shpenzimeve për forcat dhe mjetet tona pjesëmarrëse. Kostot e përafërt për pjesëmarrjen në këto stërvitje (karburant, lubrifikant) është rreth 436,712 euro. Këto kostot do të përballohen nga buxheti i alokuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2021.

## Libri “Oficerët e xhenios në rrjedhën e historisë”

Xhenierët kanë bërë një punë titanike dhe historia do t'i gjykojë gjithmonë për mirë

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

### Libra për xhenierë

Xhenierët janë specialistët më të vjetër të ushtrisë, e cila lindi dhe u zhvillua në saje të marrjes së masave fortifikuese në ndërtim objektesh mbrojtëse, krijim të kushteve gjatë luftimeve dhe përfundimi, arritja e fitores. Për xhenierët dhe armën e tyre është shkruar vazhdimisht në historinë shqiptare dhe botërore. Të sistemuara, mendimin ushtarak për armën e xhenios edhe në formë historie e gjejmë në librat e shkruar prej xhenierëve. Libri “Historia e armës së xhenios në Shqipëri” i shkruar nga Ramiz Feçori, Dr. Miti Galloshi dhe Zabit Çuku tashmë ka fituar qytetarinë dhe ka zënë vend si një nga prurjet më të mira në historinë ushtarake shqiptare. Vlerat e tij janë gjithëpërfshirëse dhe tregojnë e përshkruan përpjekjet e para deri në përsosmëri të xhenierëve në shekuj. Libri “Oficerët e xhenios në rrjedhën e historisë” sjell dukuri dhe cilësi të shumta të kuadrove xhenierë. Libri është shkruar me dashuri dhe vërtetësi, pa zbulime dhe pa u mbërthyer nga nostalgjia, duke treguar të vërtetën që i duhet lexuesit. Libri ka një rrjedhshmëri dhe është shkruar thjeshtë, pa fjalë të mëdha, lehtësisht i qartë dhe mjaft tërheqës. Në faqet e tij ne gjejmë në një hapësirë të gjerë një korpus me oficerë xhenierë të ardhur deri në kohët e sotme. Tashmë xhenierët na vijnë si dëshmitarët okularë të historisë sonë ushtarake. Është e njohur një maksimum që më shumë vlen një dëshmitar okular se sa dhjetë vetë, që kanë dëgjuar diçka. Këtë mision në libër autori Zabit Çuku e ka arritur. Në faqet e tij nuk gjejmë hakmarrje, mëllefe, mëri dhe autori nuk çirret, nuk mallkon, por portretet e tyre i ka shkruar me shumë dhembshuri, duke shkruar për kolegë, për oficerë, për inxhinierë e plot të tjerë.

### E reja për armën e xhenios pas ndryshimeve të sistemit

Xhenierët shqiptarë në shekuj kanë bërë emër, mjaft-

ton të sjellim këtu ndërtimin e kështjellave, modelimin e tyre, me të veçantat e tyre, si dhe “artilerinë shkëmbore” deri tek fortifikimi modern dhe i justifikuar, tregojnë për pjekurinë dhe mprehtësinë e xhenierëve. Arma e xhenios tashmë me futjen në NATO dhe me filozofinë e re të mbrojtjes së vendit ka një peshë dhe përgjegjësi mjaft të madhe. Kjo u provua dhe në Luftën e Fundit në Kosovë, ku rreth territorit të vendit tonë, xhenierët treguan mençuri dhe aftësi të larta në çiminimin e fushave të minuara. Më tej xhenierët shfaqën cilësi edhe në ndërtimin e urave, të ashtuquajtura të vjetra, por që për terrenin dhe vendin tonë ishin shumë efektive.

Kuadrot xhenierë në repartet ushtarake kanë qenë gjithmonë në luftë. Kjo sepse çdo stërvitje dhe mësim ata duhet ta kryenin si në kohë lufte, pra me mjetet e tyre luftarake. Kuadrot xhenierë në stërvitje dhe në mësim kanë treguar se kishin pak fjalë dhe shumë punë, ata gjithmonë ishin kokëulur, pra punëtorë të mëdhenj. Sepse çdo gjë lidhej me njerëzit, me lëvizjen e tyre, me kalimin në kushte të vështira të terrenit dhe të motit, me kalimin e pengesave ujore, me përgatitjen e terrenit për luftë etj. Të gjitha këto i kryenin kuadrot xhenierë, dhe të paktë, por tepër të përpiktë me detyrat e ngarkuara. Mbi të gjitha ata ishin njerëzor, e dinin detyrën dhe përgjegjësinë, e kurrë nuk u mburrën, por punuan të ishin dinjitoz dhe ja kanë dalë. Në repartet e këmbësorisë, xhenierët i kishim të paktë dhe i ruanim si floriri. Në BrK vetëm shefi i xhenios, kryente të gjithë stërvitjen, mësimet, punimet fortifikuese, stërvitjen me rezervistë, nxënës të shkollave, etj.

### Në Shqipëri janë kryer shumë ndërtime të objekteve fortifikuese

Fortifikimi i vendit, si ai i përhershëm, ka patur ecurinë e tij të trashëguar nga luftërat e kaluara në vendin tonë. Duke mos dashur të ndalem në sistemin e kalave (jo të pakta kudo në Shqipëri) e duke ardhur te luftërat e kohëve moderne, për të cilat flasim, theksoj se në kohën e Mbretërisë shqiptare, në vende kyçe të

terrenit u morën masa të kufizuara për ndërtimin e disa fortifikatave të përhershme. Kjo përvojë u çua më tej nga forcat pushtuese fashiste italiane e gjermane në vendin tonë, sidomos për ndërtimin e fortifikatave të veçanta, nëpër hyrje e dalje të luginave të lumenjve apo të grykave malore që të çonin në objekte të rëndësishme në thellësi. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore e menjëherë pas përfudimit të saj, në Shqipëri u mbajt në vëmendje të shfrytëzoheshin gjithë këto punime të së shkuarës. Më pas, fortifikimi i konceptuar si pjesë e Përgatitjes së Teatrit të Luftës, si një kompleks i tërë masash. Do të përsoseshin më tej ato ekzistueset me punime të lehta fushore duke u plotësuar dhe me sistemin tunel e së fundi atë të rajoneve të fortifikuara e tepër të fortifikuara.

Shqipëria, në gjithë historinë e saj ka qenë një vend paqedashës. Ajo kurrë nuk ka kërcënuar dhe nuk ka sulmuar askënd. Të parët tanë si relike për fortifikimet na lanë shenja si masa fortifikuese, na lanë kështjellat, pirgje me gurë etj., të cilat sot janë objekte studimi dhe me to krenohemi. Çdo brez punon dhe lufton për t'u mbrojtur. Ata na lanë kështjellat dhe mure guri, ndërsa brezi im dhe më parë ndërtuan objekte fortifikuese, kur dhe ku ju duheshin për paqe dhe për luftë. Tani të flasim pak për sistemin socialist i cili, siç u mendua dhe u realizua në Shqipëri, çdo ditë ne jetonim me luftën dhe prisnim të na sulmonin një apo koalicion me armiq. Kjo ishte ideja e ngritur. Ndaj dhe në bazë të kësaj ideje në Shqipëri u ndërtuan 175 mijë qendra


zjarri, të vogla e deri tek të mëdhatë. U ndërtuan tunele nëntokësore, baza e strehim për avionë, u realizuan dhe dy kryeveprat arkitektonike, si Baza Ajrore e Gjadrit dhe Baza Detare e Porto-Palermos. Më tej u ndërtuan nga komandat e batalioneve, të brigadave e deri tek njësitë më të mëdha. Këto objekte u ndërtuan me punën e oficerëve dhe ushtarëve. Për kohën që jetuam, por dhe sot fortifikimi është mëse i nevojshëm. Kjo varet nga udhëheqja strategjike e vendit. Në socializëm udhëheqja kështu mendoj dhe veproj, pasi kështu mendonin dhe vepronin edhe Fuqitë e Mëdha, me armë të sofistikuar, por dhe me punime xheniere nga më të ndryshmet. Porë në këtë fushë ne nuk ishim të vetmit që merrnim masa të tilla. Kështu p.sh. për shkak të Luftës së Ftohtë, në Norvegji u hapën mbi 11 mijë/km tunele fortifikuese, në Zvicër 16 mijë/km, në Francë 8 mijë/km, ndërsa vetëm në Moskë gjithashtu mbi 8 mijë/km tunele që shërbenin për komandën e Përgjithshme Sovjetike etj.

Sot në vendin tonë kritikohen se u bënë këto punime fortifikuese, se ato nuk duheshin bërë, e se populli nuk kishte nevojë për to. Dakort në parim, po pse të parët

tanë ndërtuan kështjella e ngritën barrikada, për t'u mbrojtur se vjen një ditë dhe ngelesh në qiell të hapur. Ndërtimi i tyre ishte një vepër kolosale që u arrit në saje të punës, mundit dhe sakrificave të të gjithë kuadrove xhenierë, të cilët në luftë të vërtetë ngritën me madhësi objektet që sot, ca i shajnë dhe ca i kanë kthyer në objekte muzeale për fitime... Pavarësisht se sot i shajnë këto vepra arti, ato në shumicën e rasteve janë kthyer dhe po kthehen në Bunk-Art, vende historike dhe turistike. Ja që dhe kështu ato kanë vlera për shoqërinë.

Përfytyrimi i Fortifikimit të Shqipërisë ishte i lidhur me hamendjet më të çuditshme të armiqve rrotull, të dy kampeve ideologjike, imperialist dhe Revizionist, të luftës mbrojtëse brenda një vendi të vogël, mes fqinjve gjithnjë armiqësorë, ç'ka solli sistemin fortifikues të pashembullt në botë, sidomos për një vend të vogël dhe pa zhvillimin e duhur ekonomik. Fortifikimi sipas studiesve ushtarake shqiptarë ishte "masë e rëndësishme e përgatitjes xheniere të vendit për luftë, që përfshin një tërësi objektesh të fortifikuara, të ndërtuara në të gjithë thellësinë e vendit, sipas një sistemi të caktuar, për realizimin e konceptit strategjik të artit ushtarak... fortifikimi kryejë sipas parimeve dhe kërkesave të Artit Ushtarak të luftës popullore, qysh në kohë paqeje, zhvillohet me ritëm më të lartë edhe gjatë kohës së veprimeve luftarake", -shkruhet në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar.

Projektimi dhe ndërtimi i tij, kishte në themel përballjen e një vendi të vogël, prej agresioneve që mund të fillonin luftën dhe të përballeshin me këtë fortifikim. Tërësia e fortifikimeve shqiptare moderne përfshin ndërtime fortifikuese të shumëllojshme, të ndërtuara në të gjithë gjeohapësirën e vendit, që nga buza e ujit gjer në vijën e kufirit shtetëror që ishin: transe, hendeklidhje, vendkomanda të njësive luftarake, batalion, bateri, brigadë, divizion, të Komandës së Përgjithshme, pozicione zjarri të baterive të Artilerisë Tokësore, Bregdetare të Artilerisë Kundërajrore, të moratjave (tipe të ndryshme), tunele të përmasave të ndryshme në zona malore, kodrinore dhe qytetore etj. Në vitin 1968, Shqipëria doli nga Traktati i Varshavës. Që prej këtij momenti shkëputës, koncepti mbrojtës, ju përshtat rrethimit të gjithanshëm. Vepra fortifikuese shqiptare zgjati për një kohë prej 20 vite të mundimshme ndërtimore që përfshin një periudhë projektimi, ndërtimi, eksperimentimi, mbështetur në parime të "Artit Ushtarak të Luftës Popullore".





## Fortifikimi në botën ushtarake

Fortifikimi nuk ishte një gjetje shqiptare e që të anatemohet apo e kundërta, të vlerësohet pozitivisht e vetëm nga ky kënd. Ishte përvojë nga ushtritë e huaja, ishte një përvojë botërore. Duke lënë mënjanë sitemin e mbrojtjes së kalave e duke ardhur në shek. XX, janë të mirënjohura jo vetëm objekte të vendit nëpërmjet kalave por dhe vija të tëra të fortifikuara. Në Luftën e Parë Botërore përmendim rajonin e fortifikuar të Verdunit, i gërshetuar me punime fushore, të shtrira përpara dhe në krahë të kështjellës. Harmonizimi i tij luajti rol vendimtar në mbrojtjen e ushtrisë franceze nga mësymja gjermane. Në mes dy luftërave botërore, nisur nga përvoja e Luftës së Parë Botërore, madje dhe si masë parandaluese, për të përballuar agresionin e mundshëm, u ndërtuan, që në kohë paqeje, disa vija të fortifikuara për gjatë kufijve shtetëror. Të tilla ishin vijat "Metaksa" (në kufirin greko-bullgar), vija "Stalin" në BRSS, vija "Valo-Alpino" (në Itali në kufi me Austrinë) e për të ardhur te ato me ndikime më të fuqishme në rrjedhat e veprimeve luftarake të palëve në Luftën e Dytë Botërore, si vija e fortifikuar franceze "Mazhino", ajo finlandeze "Manerhejm", gjermane "Zigfrid" apo te vija "Bar Lev" në Luftën e "Kipurit" (izraelo-arabe, të vitit 1973).

Në ushtri u studiuara me vëmendje përvoja praktike nga sistemi tunel i dhjetvjeçarëve të fundit të shek. XX në shumë vende europiane dhe aziatike. Shumë të njohura, madje të studiuara në vendet përkatëse nga specialistë ushtarakë shqiptarë ishin sistemet tunel në Luftën e Koresë në vitet 1950-1953, apo në Vietnam, deri nga mesi i viteve '70. Madje, nga fundi i viteve '70, sidomos për ndërtimin e Qendrave të Zjarrit (QZ) për terrenin e thyer (me elementë të veçantë e jo kupolë monolite), u studiuara fortifikimi i ushtrisë amerikane gjatë Luftës në Vietnam. Në Suedi apo në vendet e tjera nordike, në vitet '70-'80, është marrë prej nesh përvojë dhe teknikë e pajisje për ndërtime të ndryshme fortifikuese. Pra, kudo që gjendej një përvojë e që gjykohej se ajo mund të na shërbente, mundoheshim ta merrnim e ta përshtasnim për kushtet e terrenit tonë. Fortifikimi i huaj ka qenë objekt i studimit të Historisë tonë Ushtarake.

Vijat e fortifikuara, u ndërtuan kryesisht në kohë paqeje. Shtriheshin gjatë kufijve tokësorë, por dhe bregdetarë përballë agresorit të pritshëm dhe kishin kryesisht karakter mbrojtës ose gërshetim mbrojtje-bazë nisje për mësymje. Përforcoheshin më shumë në drejtimet më të rëndësishme të mësymjes së pritshme armike. Kishin për qëllim, nga njëra anë të ruanin forcën e gjallë e teknikën luftarake, të vendosur në to, të shumëfishonin rendimentin luftarak dhe, nga ana tjetër, të përballonin mësymjen e forcave kundërshtarë, t'i detyronin ato të humbisnin kohë, të përpunonin metoda e mënyra të posaçme të veprimeve luftarake për t'i pushtuar. Kjo do të harxhonte agresorëve kohën aq të dëshiruar në periudhën fillestare të luftës, si dhe do të kërkonte forca e mjetet shumë më të shumta se mësymja ndaj mbrojtjes së zakonshme. Ndërkohë vijat "Manerhejm" e "Zigfrid" shërbenin si bazë nisje e fortifikuar për kundërmësymje apo mësymje. Në tërësi vijat e fortifikuara përbëheshin nga ndërtime mbrojtëse të karakterit të përherëshëm, kryesisht nëntokësore e pjesërisht me elemente betonarme, të ndërthurura me mburoja çeliku në sipërfaqe. Lufta e Dytë Botërore tregoi se ato, pavarësisht qëndrësës, u pushtuan nga mësymësi. Për të kuptuar më mirë fortifikimin tonë, le

të veçojmë shkurtazi disa dukuri të ndërtimit, por dhe të zhvillimit të veprimeve luftarake në disa prej këtyre vijave, me anë të tyre të forta, por dhe të dobëta, të shfrytëzuara nga kundërshtarët.

### Mendimi për këto ndërtime fortifikuese...

Përgatitja e Teatrit të Luftës, apo fortifikimi i vendit tek ne, ishte një realitet sa i njohur, aq i përfolur, jo aq nga përmasat e gjera që mori tek ne, se sa për vlerat e tij. Kjo nuk ishte një përvojë thjeshtë shqiptare dhe pse pati një origjinalitet të theksuar shqiptar: Parimisht ka përbërë e përbën një nevojë, një domosdoshmëri, sidomos për vendet që në themel të strategjisë së vet ushtarake kishin strategjinë e mbrojtjes.

Gjysma e dytë e shek. XX, u shoqëra nga përsosje masive të teknikës dhe të armatimit ushtarak, rritje e shpejtësisë e manovrimit të trupave, si dhe e forcës shkatërruese të goditjeve të befasishme masive nga toka, deti e sidomos ajri. Ushtarakisht të gjitha palët ndjeheshin të kërcënuara. Madje jo thjeshtë në frontin e luftës, por në të gjithë thellësinë e vendit. Këtë, secila palë, pavarësisht karakterit e përmbajtjes së strategjisë ushtarake, ishte e detyruar të merrte masa të fuqishme pasive mbrojtëse. Nga shteti në shtet dhe nga ushtria në ushtri, ndryshonin vetëm rrugët që ndiqeshin, forcat e mjetet që caktonin e përmasat mbrojtëse që realizoheshin. Kështu SHBA, për përballimin e rrezikut që e kërcënonte territorin e saj nga raketa kundërshtarë (me mbushje të zakonshme, bërthamore, kimike e biologjike), si masë kryesore zgjodhën atë që e quajtën, në kohën e Presidentit Regan, "Lufta e Yjeve", apo të "Mbrojtjes kundër raketave". Kjo masë e përsosur përbën në ditët e sotme, një nga prioritetet e NATO-s dhe të SHBA-së. Këtë rrugë, dhe pse një shtet me politikë shtetërore e strategji ushtarake tradicionalisht sulmuese, e ndoqi BRSS, rivalja kryesore e SHBA. Në kushtet e këtij rivaliteti mes dy blloqeve ushtarake, shteti ynë i kushtëzuar nga një përballje mes tyre në hapësirën ballkanike, ndoqi rrugë të tjera e më optimale për kushtet e mundësitë tona, sikurse ishte fortifikimi i teatrit të luftës. Fortifikimi përdorej nga vet shtetet e mëdha, qoftë për mbrojtjen e vetë raketave, duke i vendosur apo futur ato në strehime a pozicione zjarri betonarme, nga ku mund të jepnin më së shumti goditjet, por dhe për mbrojtjen e objekteve të rëndësishme strategjike e jo vetëm. Shtypi ushtarak i asaj kohe shkruante për subvencionime të shteteve në Europën Qendrore në vijat ku pritej të përballeshin dy blloqet ushtarake, apo në SHBA për ndërtimin e strehimeve, në shtëpi e pallate të ndryshme apo pajisjen e kateve përdhese, për t'u shfrytëzuar si strehime apo fortifikata në rast lufte.

### Mesazh për armën dhe kuadrot xhenierë për 100 vjetorin

Mezashi im për kuadrot xhenierë është se ata kanë bërë një punë titanike dhe që historia do ta gjykojë gjithmonë për mirë. Gjurmët e tyre janë të arta dhe për këtë flet vetë realiteti i ndërtimeve kolosale të ndërtuara me përkushtim dhe me një qëllim të vetëm, për t'i shërbyer atdheut me punë, djersë dhe ndershmëri. Ky ishte dhe qëllimi fisnik i tyre në tërë këtë përpjekje kolosale të bërë në çdo cep të vendit tonë. Urimet më të mira dhe të jenë kryelartë se detyrën ndaj shoqërisë dhe atdheut e kanë kryer me përkushtim!




**M**inistri i Mbrojtjes Anton Quni, priti më 4 shkurt 2021, ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Nicholas Abbott. Duke i uruar mirëseardhje, Ministri Quni shprehu falënderimin për Mbretërinë e Bashkuar në mbështetjen e ofruar deri më tani në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e gjithmbarshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Ministri Quni theksoi se mbështetja e deritashme në fushën e arsimimit dhe stërvitjes si dhe forma tjera e ofruar nga Mbretëria e Bashkuar ka qenë shumë e rëndësishme në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e kadrove profesionale dhe ndikim të lartë në realizimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme me forcat aleate të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-së siç është edhe vet Mbretëria e Bashkuar. Ministri Quni e informoi ambasadorin Abbott edhe me procesin e implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, respektivisht procesin e rekrutimit të stafit ushtarak dhe civil të MM dhe FSK-së duke ritheksuar se ky proces është duke u realizuar në transparencë të plotë dhe në monitorim edhe nga organizatat tjera kredibile. Ai shprehu interesimin për mbështetjen profesionale edhe të ekspertëve britanik për procese përkatëse për të avancuar edhe më tej Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në institucione efektive me vlera dhe standarde të vendeve të NATO-s. Nga ana e tij, ambasadori Abbott, premtoi se Mbretëria e Bashkuar, sikur

Ministri Quni priti ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar Nicholas Abbott

## Mbretëria e Bashkuar në partneritet me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në

Mbështetja e deritashme në fushën e arsimimit dhe stërvitjes si dhe forma tjera e ofruar nga Mbretëria e Bashkuar ka qenë shumë e rëndësishme



edhe deri më tash, do të vazhdojë partneritetin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në në mënyrë që të përmbushë me sukses të plotë objektivat e përcaktuar, respektivisht procesin e tranzit-

cionit sipas planit përkatës. Në fund, të dy ishin të një qëndrimi që të intensifikohet edhe më tej bashkëpunimi bilateral në mes dy vendeve mike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

### CEREMONIA

## Medalje dhe mirënjohje për 61 zyrtarë të MM-së dhe FSK-së

**N**ë Ministrinë e Mbrojtjes, u organizua ceremonia e ndarjes së medaljeve dhe mirënjohjeve me rastin e shënimit të Ditës së Forcës dhe me rastin e shënimit të 13 Vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni ka dekoruar me medalje dhe mirënjohje 61 zyrtarë të MM-së dhe pjesëtarë të FSK-së.

Me këtë rast, Ministri Quni i përgëzoi të gjithë zyrtarët dhe pjesëtarët e dekoruar me medalje dhe mirënjohje, për performancën e veçantë gjatë kryerjes së detyrave dhe kontributin e dhënë në arritjet e përgjithshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Kurse nga ana e tij komandanti i FSK-së, gjeneraljejtënant Rrahman Rama falënderoi Ministrin Quni për vlerësimin dhe bashkëpunimin e ngushtë si dhe përgëzoi të dekoruarit duke thënë se ky vlerësim është motiv i fuqishëm për të vazhduar edhe në të ardhmen në realizimin e detyrave me profesionalizëm, përkushtim si dhe shërbim vetëmohues. Medaljet dhe mirënjohjet për zyrtarët e MM-së dhe pjesëtarët e FSK-së ndahen sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht Rregullores së Ministrisë së Mbrojtjes për medalje dhe mirënjohje.



Ministri Quni; puna e palodhshme e radhit FSK-në në vendin e parë

## FSK ndërton urën mobile “Mabey Johnson” e cila do të lidhë 11 fshatra

**N**ë fshatin Hajnoc të Komunës së Kamenicës, u përruar ura mobile Mabey Johnson“ e ndërtuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës, pas shembjes së urës së vjetër si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut. Në ceremoninë e përrimit të urës „Mabey Johnson“ morën pjesë: ministri në detyrë i Mbrojtjes z. Anton Quni, zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneral major Enver Cikaqi, kryetari i Komunës së Kamenicës z. Qëndron Kastrati, përfaqësues të KFOR-it amerikan, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe oficerë të Xhenios të FSK-së. Shiritin e përrimit të urës e preni ministri në detyrë z. Anton Quni, kryetari i Kamenicës z. Qëndron Kastrati dhe zv. komandanti i FSK-së, gjenerali Enver Cikaqi. Me këtë rast, ministri në detyrë z. Quni u shpreh se kjo ngjarje pasqyron vlerat që personifikojnë ushtarët e FSK-së, vlerën e humanizmit dhe solidaritetit me qytetarët. Ministri Quni, më tej tha: „Profesionalizmi, efikasiteti dhe zelli i secilit pjesëtar të ekipit të inxhinierëve, në kuadër të Regjimentit të Xhenios të FSK-së, rezultoi me përrmbushjen e këtyre detyrave në afat rekord, pavarësisht kushteve të vështira klimatike, për të përrmbushur njëkohësisht parimet kushtetuese dhe ligjore - mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile.“ Ai, gjithashtu shtoi se: „Puna e palodhshme e radhit FSK-në në vendin e parë, në mesin e institucioneve shtetërore, të vlerësuar nga qytetarët; si institucioni më i besueshëm. Disiplina dhe kultura institucionale e kultivuar

Ura “Mabey Johnson” ka një gjatësi prej 36.58 metra dhe gjerësi 4.5 metra, me kapacitet të peshës prej 40-80 ton. Kjo urë ka rëndësi të madhe për banorët e kësaj ane pasi lidhë 11 fshatra



me standardet më të larta ushtarake, kanë bërë që Kosova të konsiderohet një faktor i rëndësishëm për paqen dhe sigurinë në nivel ndërkombëtar. Edhe pak ditë na ndajnë, kur trupat tanë do t'i bashkohen ushtrisë amerikane për të kontribuar në misionin e parë historik paqeruajtës ndërkombëtar”. Ministri Quni po ashtu falënderoi autoritetet komunale dhe Ministrinë e Infrastrukturës, të cilat së bashku kontribuan në rikthimin e normalitetit dhe lehtësimin e qarkullimit të lëvizjes si një domosdoshmëri për secilin. Ndërsa, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneral major Enver Cikaqi, ka përrgëzuar xhenierët e FSK-së për punën dhe angazhimin në ndërtimin e kësaj ure, e cila ka rëndësi të madhe për komunitetet që jetojnë në këtë vend. Ai, theksoi se „FSK-ja ka kapacitete për mbështetjen e autoriteteve civile dhe këtë e ka dëshmuar gjatë vërshimeve të fundit të angazhuara në njësinë e kërkimshpëttimit në dhjetëra raste në të

gjithë Kosovën“.

Kryetari i Kamenicës, z. Qëndron Kastrati, pasi falënderoi ministrin Quni, zv. komandantin Cikaqi dhe FSK-në, për ndërtimin e shpejtë të kësaj ure, tha se „sot është një ditë e veçantë - kur po e inaugurojmë këtë urë të ndërtuar nga FSK-ja. Si gjithëherë operacionet e FSK-së na bëjnë krenar. Këtë herë edhe më shumë, sepse reagues ndaj një fatkeqësive natyror me shpejtësi për të rikthyer komunikimin e fshatrave; fëmijëve, pleqve, të sëmurëve e të gjithëve pa dallim. Z. Kastrati në emër të Komunës në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi ndau Mirënjohje për FSK-në. Xhenierët e FSK-së këtë urë e ngritën për 9 ditë pune, edhe pse ngritja e saj ishte planifikuar për 14 ditë pune. Ura „Mabey Johnson“ ka një gjatësi prej 36.58 metra dhe gjerësi 4.5 metra, me kapacitet të peshës prej 40-80 ton. Kjo urë ka rëndësi të madhe për banorët e kësaj ane pasi lidhë 11 fshatra.



NATO ka njoftuar për hapjen e linjave të reja në hapësirën e ulët ajrore mbi Kosovën. Në një njoftim të Aleancës Veri-Atlantike thuhet se kjo është një arritje e rëndësishme për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore mbi Kosovën. Kjo masë, sipas njoftimit, do të përmirësojë trafikun ajror civil nga dhe në aeroportin e Prishtinës.

“Përfitimet do të vërehen në udhëtime më të shpejta, më pak shpenzim i karburanteve dhe ulje të ndotjes së ajrit”, thuhet në njoftim. Që nga viti 1999 procesi i normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës është mbështetur në vazhdimësi nga NATO. Kjo është bërë në kuadër të takimeve për Normalizimin e Aviacionit në Ballkan, në kuadër të cilave kanë marrë pjesë përfaqësues të vendeve Aleate, autoritetet e aviacionit, ato ushtarake dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare, përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, Agjencinë Europiane të Sigurisë së Aviacionit.

Në vitet e fundit, NATO përmes Takimeve të Normalizimit të Aviacionit në Ballkan ka lehtësuar zyrtarizimin e një Marrëveshje Kuadër midis KFOR dhe Islandës. Agjencia e Sigurisë së Transportit të Islandës (ICETRA) tani po vepron si një Funkcion i Mbikëqyrjes së Sigurisë në mbështetje të Komandantit të KFOR-it, i cili mban autoritetin kryesor për përdorimin e hapësirës ajrore mbi Kosovë. Ai kryen vëzhgimin e të gjitha zgjidhjeve teknike që lejojnë krijimin e rrugëve të reja të drejtpërdrejta, në hapësirën e ulët ajrore, midis Prishtinës dhe qyteteve të tjera.

Në përputhje me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjen Teknike Ushtarake të vitit 1999, por edhe me ligjet e tanishme në Kosovë, komandanti i misionit të KFOR-it, përkatësisht NATO-s, është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës.

Përmes kontributit të Agjencisë Islandeze të Sigurisë së Transportit, marrëveshjet teknike janë nënshkruar gjithashtu midis Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror

## ALEANCA VERI-ATLANTIKE

# NATO konfirmon linja të reja në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës



Që nga viti 1999 procesi i normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës është mbështetur në vazhdimësi nga NATO



Shqiptar (Albcontrol) dhe Ofruesit të Shërbimit të Navigacionit Ajror në Prishtinë (ASHNA), për krijimin e linjave të reja të drejtpërdrejta për në Prishtinë përmes Shqipërisë.

Kjo lejon linja më të shkurtëra për linjat ajrore që vijnë nga veriu, me përfitime nga koha dhe kursimet e karburantit dhe ndotje më të ulët të ajrit.

## BASHKËPUNIMI

# Donacion me 250 tituj librash për bibliotekën e FSK-së

Në Kazermën “Adem Jashari” të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë, menaxheri i shtëpisë botuese “Fidani” nga Prizreni, prof. Berat Batiu i dhuroi Bibliotekës së FSK-së, një donacion me 250 tituj librash. Me këtë rast, Z. Batiu u shpreh i kënaqur për mundësinë e dhurimit të këtyre librave për bibliotekën e FSK-së, të cilat do të jenë në shërbim të ushtarëve dhe oficerëve të saj. Librat i pranoi koordinatori i Klubit të Oficerëve, rreshteri shtabor Hyzer Gashi, i cili në emër të FSK-së e falënderoi profesorin Batiu, për librat e dhuruara. Librat janë nga fusha e letërsisë, artit, kritikës letrare, poezisë, filozofisë dhe nga fusha ushtarake.

# Plan bilateral në fushën e mbrojtjes

**P**as një pune të përbashkët mes dy delegacioneve, në Shtabin e Përgjithshëm të Mbrojtjes së Republikës së Italisë, në Romë, për herë të parë, u nënshkrua plani bilateral në fushën e Mbrojtjes mes ministrive të mbrojtjes së Kosovës dhe Italisë. Me protokoll zyrtar, nënshkrimi i planit bilateral u bë nga drejtori i departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euroatlantike (DBNIE), kolonel Hasan Hoxha në emër të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe kolonel David Morpurgo nga shtabi i Përgjithshëm i Mbrojtjes së Republikës së Italisë.

Plani bilateral përmban aktivitetet kryesore të fushës së mbrojtjes të cilat do të realizohen mes Forcave të Armatosura të Republikës së Italisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Të dy palët u pajtuan që bashkëpunimi në të ardhmen të zgjerohet e intensivkohet edhe më tej. Pjesë e delegacionit nga Kosova ishin edhe shefi i Departamentit të Planifikimit dhe Financave në SHPFK, kolonel Agron Bajrami, shef i Departamentit për Operacione dhe Trajnim në SHPFK, kolonel Ejup Maqedonci, dhe znj. Edona Abazi Zyflifaj, zyrtare e DBNIE-së.



Nga pala italiane në bisedime ishte prezent edhe kom. Miretti, nga Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes së Republikës së Italisë.

Delegacioni kosovar në Romë u prit edhe në ambasadën e Republikës së Kosovës në Itali, nga ana e ambasadores Lendita Hax-

hitasim. Ajo u njoftua nga ana e delegacionit ushtarak për planin bilateral të nënshkruar. Nga ana e saj, ambasadorja Haxhitasim premtoi mbështetjen e saj në funksion të realizimit sa më efektiv të planit përkatës si dhe angazhimin e saj në forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit mes dy ministrive dhe forcave respektive.

## Marrëveshja e bashkëpunimit mes MM-së dhe ASK-së

**N**ë mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua nga znj. Rozafa Ukimeraj, sekretare e përgjithshme e MM-së dhe Ilir Berisha, zëvendësues i kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Marrëveshja e bashkëpunimit mes MM-së dhe ASK-së, ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit institucional në mes të dy palëve; me qëllim të lehtësimit të procedurave në afrimin e të dhënave statistikore për MM nga

# Lehtësi në proceduarat dhe afrimin e të dhënave statistikore për MM



ASK-ja, si dhe ofrimin e ndërsjellë të trajnimeve, mbështetja në organizimin e aktiviteteve, si dhe pjesëmarrja në aktivitetet e përbashkëta. Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës në bazë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të krijojnë lehtësira administrative për bashkëpunim institucional mes palëve duke përcaktuar fushat dhe detyrimet përkatëse të cilat janë pjesë e kësaj marrëveshje.

# NATO mbështet gratë dhe vajzat në shkencë

**M**e rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave dhe Vajzave në Shkencë, po sjellim tre gra të reja, se si ato po bëjnë përparime të mëdha në teknologji dhe inovacion, me mbështetjen e Programit të Shkencës për Paqen dhe Sigurinë (SPS) të NATO-s. Në vitin 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (KB) themeloi këtë Ditë Ndërkombëtare, të mbajtur çdo 11 Shkurt, për të njohur rolin kritik që gratë dhe vajzat luajnë në shkencë dhe teknologji. Kjo ditë promovon angazhimin e grave dhe vajzave, të cilat vazhdojnë të preken nga paragjykimet dhe stereotipet gjinorë që kufizojnë aksesin dhe pjesëmarrjen e tyre në fushën shkencore. Sipas Kombeve të Bashkuara, më pak se 30 përqind e studenteve në të gjithë botën janë gra. Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) gjithashtu raporton se regjistrimi i studenteve të reja femra është veçanërisht i ulët në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), shkencat natyrore, matematikën, statistikën dhe inxhinierinë. Tregimet më poshtë tregojnë shembuj të tre shkencëtareve të reja nga vendet partnere të NATO-s që thyejnë këtë trend.

**Dr. Zheljka Antiç** është Profesor i Asociuar i Kërkimit në Institutin e

Shkencave Bërthamore, Vinça në Serbi. Ajo ka një interes të përjetshëm për shkencat, gjë që e motivoi atë të përfundonte një doktoraturë në kimi dhe teknologji kimike. Dr. Antiç vlerëson që hulumtimi vazhdimisht e trajnon trurin e saj të jetë logjik, të mendojë qartë dhe të bëhet më i mirë në zgjidhjen e problemeve. "Duke qenë një shkencëtare, unë kam një ndjenjë që puna ime ka rëndësi dhe se ajo do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve, të paktën në planin afatgjatë. Një karrierë në shkencë hap mundësinë për të zgjidhur sfidat globale në lidhje me shëndetin, sigurinë, ndryshimin e klimës, energjinë e qëndrueshme dhe ushqimin, vetëm për të përmendur disa", tha ajo. Megjithëse

më shumë gra sesa burra ndjekin karrierë në kërkimin shkencor në Serbinë e saj të lindjes, Dr. Antiç ende beson se vajzat dhe gratë e reja duhet të zgjedhin profesionin e tyre pa paragjykimet. Ajo pëlqen të flasë për këtë temë edhe me vajzën e saj 11-vjeçare dhe miqtë e saj, duke i inkurajuar ata të ndjekin interesat e tyre të karrierës "Këshilla ime për të gjithë të rinjtë e interesuar në një karrierë në shkencë, veçanërisht vajzat dhe gratë e reja karriera është brenda mundësive të tyre", shtoi Dr. Antiç. Ajo po merr pjesë në një projekt shumëvjeçar SPS që synon zhvillimin e një teknologjie të re për të zbuluar dhe njohur avujt e eksplozivëve në zona të mëdha. Projekti përfshin gjithashtu ekipe





kërkimore nga Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

**Dr. Marwa Qarage** është Asistent Profesor në Universitetin Hamad Bin Khalifa në Katar. Duke punuar në një fushë të mbizotëruar nga meshkujt, ajo hasi "një presion të madh për të lulëzuar, jo vetëm për zhvillimin tim, por sepse unë shërbeva si një model për gratë e tjera të reja, gjithashtu në rajon". Për të përballuar këtë presion, ajo bëri partneritet me të vetmen grua tjetër në fakultet dhe së bashku ato zhvillojnë ide kërkimore plotësuese. "Unë besoj fuqimisht se të qenit e ditur, e pajisur mirë dhe të kesh grupe mbështetëse dhe një rrjet bashkëpunues të grave shkencëtare janë çelësi për të ndihmuar gratë të kenë sukses në fushat e lidhura me shkencën," deklaroi Dr. Qarage. "Unë mendoj se gratë shpesh ndihen të konfliktuara kur bëhet fjalë për të ndjekur karrierën e tyre ose për të krijuar një familje thjesht sepse nuk shohin shumë gra që kanë pasur sukses në të dy zonat", vërejtji Dr. Qarage. "Është e rëndësishme që vajzat e reja të shohin gratë shkencëtare dhe të mësojnë nga historitë e tyre të suksesit. Kjo dukshmëri e grave në një fushë të mbizotëruar nga meshkujt do të inkurajojë më shumë gra të ndjekin karriera të tilla", shtoi ajo. Dr. Qarage po punon me homologët e saj në Jordani dhe Portugali në një projekt shumëvjeçar SPS që synon zhvillimin e sistemeve për të rritur sigurinë e rrjeteve të Internetit të Gjërave, të cilat përfshijnë pajisje informatike të ndërlidhura, makina dixhitale dhe sensorë.

**Olesea Caftanatov** është një studiuese e re nga Republika e Moldavisë, e cila aktualisht po punon drejt një doktorature në Institutin Vladimir Adrunachievici të Matematikës dhe Shkencave Kompjuterike në Kishinau. Zonja Caftanatov beson se të ndjekësh një karrierë në shkencë është si një fushë e mundësive të pafundme. Sidoqoftë, si për shumë gra të tjera, pajtimi i qëllimeve të familjes dhe karrierës së saj ishte një sfidë. "Si nënë, mund të them se jemi të përfshira në shumë detyra në çdo kohë dhe ndihemi si një meri-



mangë që tërhiqet nga këmbët në të gjitha drejtimet. Pavarësisht kësaj, të shtyrë nga pasioni për shkencën, ne krijojmë disi rrjetë mahnitëse". Forca e saj lëvizëse është një dëshirë për t'u njohur si ekspert në fushën e saj kërkimore në TIK. Ajo përpiqet për këtë qëllim përmes zellit dhe këmbënguljes. Ky është mesazhi që ajo u përcjell studentëve të saj të cilët besojnë se vetëm individë me talent të jashtëzakonshëm duhet të përfshihen në kërkime. "Pothuajse të gjithë kemi lindur njësoj të talentuar. Talenti nuk është çështje e aftësive të lindura, por më tepër e zellit", shpjegon Olena Caftanatov. Ajo është e përfshirë në një projekt SPS që synon të rrisë efikasitetin e reaguesve të parë në katastrofa në shkallë të gjerë duke mbështetur vendimmarrjen e tyre me inteligjencën artificiale. Përmes këtij projekti, ekipi i saj po bashkëpunon me studiues nga Kroacia, Gjermania, Rumania dhe Shtetet e

Bashkuara.

Si SPS mbështet gratë e reja në shkencë: Pjesëmarrja në aktivitetet e mbështetura nga Programi i Shkencës për Paqen dhe Sigurinë e NATO-s është i hapur për shkencëtarët dhe ekspertët pa paragjykim gjinore nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s. Më shumë se qaq, projektet shumë-vjeçare të Programit ofrojnë mundësi për të mbështetur shkencëtarët e rinj në fazat e hershme të karrierës së tyre përmes bursave. Midis 40 projekteve të reja SPS të filluara në vitin 2020, 37 nga 88 përfituesit e rinj të bursave ishin gra. Aktivitetet e Programit gjithashtu ofrojnë mundësi mësimi përmes kurseve të trajnimit për tema shumë të specializuara, të tilla si teknologjitë e përparuara dhe mbrojtja kibernetike. Për më tepër, Programi dëshiron të evidentojë talentet e përfshira në aktivitetet e tij, duke siguruar modele për brezat e rinj të shkencëtarëve.



# In Memoriam

## Xhemil Çela-Profesori i mënçur dhe shkencëtari ushtarak



PROF. ASOC. DR.  
ZAHO GOLEMI

*In Memoriam për njerëzorin, profesorin e mënçur, shkencëtarin ushtarak, krijuesin, birin e Gusmarit të Kurveleshit Xhemil Xhafo Çela, që u shua këtë më 20 shkurt të 2021-it, që ngeli i pashlyer në kujtesën e ushtarakëve, Shoqatës "Labëria", miqve e shokëve, bashkëfshatarëve si model i mirësisë njerëzore, një emër i pashoq shoqëror, një familjar i përkushtuar për fëmijët Lizën dhe Arbenin, një gjysh i dashur dhe stërgjysh i dhimbsur, një shkrimtar mendjemprehtë me dritë në shpirt, një lis Labërie, që me trashëgiminë që la do të ndriçojë me pjekurinë e mendimit)*

**A**skush nuk do ta besonte lajmin e hidhur të 20 shkurtit, për ndarjen nga jeta të Xhemil Çelit. Për më tepër më 15 shkurt kishte bërë postimin e fundit në facebook. Dhe mos e beso shkurtin, që shkurtoi rrugët e shtegëtimit të jetës për burra me mend e me peshë që kishin lindur seriozë dhe që i shoqëroi korrektësia në jetë. Ky lajm i kobshëm, preku thellë shpirtërisht, çdo njeri që e ka njohur ish ushtarakun madhor të zbulimit, pedagogun e talentuar, mësimdhënës i apasionuar, punonjësin e kërkuesin shkencor, redaktor e kryeredaktor i "Revistës ushtarake", drejtuesin madhor të strukturave të zbulimit të Ushtrisë, që la gjurmë të thella në piramidën ushtarake shqiptare të drejtimit, veprimtarin shoqëror, shkrimtarin e fjalës së saktë të peshuar dhe kontrolluar me rigorozitet dhe me vend, ish-sekretarin e përgjithshëm të Shoqatës "Labëria", "Nderi i Kombit".

Tre dekada më parë rrugët na takuan në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, në Tiranë, ku shefi i Katedrës së zbulimit ishte kryelektor në lëndët e veta, edhe pse rrethohej nga shtatë profesorë e doktorë me tituj. Por kur hynte Xhemil Çela në auditor, hynte mendimi i pushtetshëm. Fliste urtë dhe butë por me mendim krejtësisht të gdhendur të pjekur dhe me logjikë të ftohtë, me mendim të thellë. Ishte komunikues me auditorin si ai, që rrallëkush e zotëronte këtë cilësi. Nëse dikush duhet të bëhej i zhurmsëm për të vendosur rregullin dhe qetësinë tek profesor Xhemil Çela nuk kishte nevojë fare për përgjegjësa grupesh mësimore. Fliste pësha e fjalës. Fjalën e kishte mënçuria dhe duhet të kishe vëmendje sepse për thellësinë e mendimit nuk i kthehej sërish problemit. Kur hynte mbante një dosje të



zezë dhe leksioni në fletë letre sa pëllëmba e dorës. Por ato hidheshin mbi tavolinë për korrektësi pedagogjike dhe askush nuk e kuptonte se si kalonin 90 minuta leksion (për arsye se ora akademike e asaj periudhe ishte 90-të minutëshe). Pas impresioneve të para rrugët tona në tre dekada do të kryqëzoheshin shpesh dhe Xhemil Çela do të ngelej përherë një ushtarak dinjitoz, enciklopedist, pedagog, metodist i shkëlqyer, labi me rrënjë, që ka lënë gjurmë të

pashlyeshme në monografite të tij dhe që deri në këtë mes shkurti ishte pranë kompjutrit me librin e radhës në dorë duke shkruar e redaktuar, duke punuar me përkushtimin e një djali të ri që "arkivi lëvizës" të ngelet pronë intelektuale e ushtarakëve e ish-ushtarakëve, e vendlindjes së tij Gusmarit, Kurveleshit, e Labërisë që aq shumë e donte si dhe e mbarë elitës intelektuale shqiptare të fushës së sigurisë dhe të mbrojtjes. Kushdo që e ka njohur oficerin e zbulimit Xhemil Çelën ka vënë re karakteristika të veçanta si shembull korrektesie, njeri gjithmonë i veprimit dhe i angazhuar, kontribues i çmuar në rrugëtimin e gjatë të Shoqatës Labëria, një burrë vizionar, me eksperiencë drejtimi, që punonte me një disiplinë të hekurit, që në fakt buronte nga të qenit ushtarak me karrierë në hierarkinë e lartë ushtarake të zbulimit të Ushtrisë Popullore (sot Forcat e Armatosura). Xhemili kishte cilësi të rralla të labit të mirë, që mençurinë dhe sakrificën e vinte në punë, që humanizmin shoqëror e kishte më shumë se profesion.

Xhemili nuk ishte vetëm një ushtarak i zoti, veprimtar i pa përtuar, por edhe kuadër me dije të thella akademike e teorike, studiues i thekur, skrupuloz me pretendime shumë të mëdha si pedagog shembullor, sa që rrallë janë ata që arrijnë nivelin e "stekës" së tij akademike. Ai ishte dhe mbeti deri në fund të jetës së tij një Personalitet i Shquar i Forcave të Armatosura dhe i Labërisë, një patriot i pa epur për çështjen kombëtare shqiptare në gjithë shtrirjen tonë kombëtare kudo ku flitej shqiptarçe, që rrezatonte me mendimet e tij plotësisht të thella si dhe të argumentuara për zhvillimet në Kosovë dhe për situatën e Çamërisë e deri për shqiptarët e Malit të Zi dhe Maqedonisë Veriore, përfshi edhe shqiptarët e nëpërkëmbur të Luginës së Preshevë, Metvegjë e Bujanoc. Xhemili ishte promotor i përkujtimit në vendlindje të tij tek Lisat e Kadhe, vendin historik ku vëllezërit e një gjaku kanë nderuar atdhetarizmin dhe kanë ngritur flamurin shqiptar më 11 Maj 1911, ku flamuri dhe shqiponja dykrenare qëndroi si simbol i historisë në "Lajthiz-Gusmar-Kurvelesh", që ai gjykonte se duhej festuar e kthyer në vend peligrinazhi patriotik, në vendin e zjarrit të atdhetarizmit, si një simbolikë mjaft e gjetur dhe e goditur.

### **Një jetë plot përkushtim me arritje e sfida. Nëntoger në moshën 17 vjeçare**

Xhemil Çela është lindur në Gusmar të Kurveleshit më 2.4.1937. Ka qenë ushtarak madhor i zbulimit, publicist, patriot, "Nderi i Qarkut Gjirokastrë" (2006), "Personalitet i shquar i Labërisë" (2007). Shkollën shtatëvjeçare dhe tre klasë të shkollës së mesme i kreu në Tepelenë dhe në Tiranë në ShMP "Skënderbeu deri në vitin 1953. Më pas, deri në vitin 1954, përfundoi studimet ushtarake dhe u specializua në zbulim, pranë shkollës së Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha".

Prej rezultateve të shkëlqyera gradohet si nëntoger në moshën 17 vjeçare. Në vitin 1955 përfundon Kursin e Lartë Ushtarak një vjeçar po në fushën e zbulimit, pranë të njëjtës shkollë. Në vitet 1959 - 1961 vazhdoi fakultetin për zbulim agjenturor në Moskë, por për shkak të krizës shqiptaro-sovietike kthehet si shumë studentë të tjerë shqiptarë në Shqipëri. Studimet gjitharmëshe i përfundon gjatë viteve (1968-1970) pranë Akademisë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm "Mehmet Shehu" në Tiranë. Ka kryer detyra të ndryshme në shërbimin e zbulimit ushtarak duke arritur deri në detyrën e zëvendës drejtorit (1971)- (1975), pedagog, punonjës shkencor dhe shef i katedrës së Zbulimit e Ushtrive të Huaja në Akademinë e Shtabit të

Përgjithshëm dhe anëtar i Këshillit shkencor të Akademisë (1981-1991), kryeredaktori i "Revista Ushtarake"-organ teoriko shkencor i Akademisë (1991)-(1992), duke nxjerrë numurat e parë të saj. Në prill (1992) del në pension pleqërie. Zotëron gjuhën italiane, ruse, greke, serbe, kroate, dhe franceze.

Aktiviteti publicistik është shumë i pasur si bashkautor i katër librave me objekt Njohuri mbi Ushtritë e Huaja për përdorim të brendshëm në ushtri, botime të viteve '80. Ka botuar gjithashtu monografinë "Familja dhe fisi Çela në shekuj" (1660-2000), "Jetuam paqen e kërcënuar", "Historiku i shoqatës "Labëria" 2006; botim me bashkëautor "15 vjet Shoqatë "Labëria" (12 dhjetor 1991-12 dhjetor 2006), 2020, në gazetën e shoqatës si dhe artikuj e studime për probleme të mbrojtjes e të sigurisë kombëtare. Në 2015 publikoi librin interesant "Jetuam paken e kërcënuar", Edlora, Tiranë 2015. Dy vjet më vonë më 2017 publikoi "Fenomeni fajde dhe revoltat popullore në Shqipëri 1997", BOTIMET M&B, Tiranë, 2017. Në vitin 2018 publikon "Shkurt '91-ngjarjet në shkollat ushtarake dhe monumenti i Enver Hoxhës (nën optkën e një pjesëmarrësi). Janë të shumta publikimet akademike si autor dhe bashkëautor i botimeve ushtarake (1982-1992), në grupin e punës për hartimin e "Rregullore e nënrepartëve të zbulimit ushtarak në luftim", Tiranë 1976; Album me skema i repartëve e njësisve të Ushtrive të Huaja në llojet e ndryshme të luftimit e operacionit", Tiranë 1986; "Veprimet e nënrepartëve të UH në luftim", Tiranë, 1990; "Veprimet luftarake të nënrepartëve të desantit detar e ajëror në luftim", Tiranë, 1990.

Është gjithashtu bashkëautor i botimit shkencor "Enciklopedi e Kurveleshit" (2009). Pas daljes në pension, si veprimtar shoqëror, është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i Shoqatës Kulturore Atdhetare "Labëria" që nga kuvendi i parë themelues i saj në vitin 1998 deri në Kuvendin e fundit më 2018-tën. Jeta dhe aktiviteti i tij përmbledhen në një libër "Zbuluesi ushtarak, njeriu i bukur Xhemil Çela, monografi me autor Prof. Assoc. Bernard Zotaj e Bashkim Qeli, në vitin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar më 2012. Ai ka qenë autor i dhjetra referateve e kumtesave, materialeve me vlerë shkencore etj si dhe një bashkëpunor i përhershëm i shtypit. Mban 4 Urdhëra e dy Medalje, dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të RSH si dhe me meritë të plotë është vlerësuar "Personalitet i shquar i Labërisë" dhe "Nderi i Qarkut Gjirokastrë" nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

### **Labi nga Gusmari që bëri emër në ushtri dhe shoqëri**

Ai nuk besonte fort në botën e përtejme, por Xhemil Çela rrugëtoi për lart në parajsën e Labërisë në qiellin e Shqipërisë. Ai ishte dhe mbeti shpirtërisht i lidhur fort me vendlindjen me Gusmarin dhe bëri emër në ushtri, në shoqëri, duke u bërë gjithënjë dhe më i njohur me aktivitetin e tij vecanërisht me shoqatat, edhe pse në thelb ishte ndër bijtë më të shquar dhe më të respektuar të Labërisë, një mik për kokë, i këshillës së urtë dhe vlerë e madhe njerëzore, njeri me vrytute të larta njerëzore dhe patriotike, një referencë historike si një kronikan që dokumentoi në mënyrë të qënësishme jetën shoqërore dhe shtetërore shqiptare në mënyrë të jashtëzakonshëm, sit a kishte detyrë shtetërore, si mision ushtarak që duhej kryer me të patjetër.



Ai ishte dhe mbeti vertebra që mbliidhte miq e dashamirës në organizatat shoqërore, vecanërisht vijueshmëria e ekzistencës së Shoqatës kombëtare "Labëria" ka të mbrujtur cdo document nga dora e tij, personaliteti i tij ishte premise e parë e suksesit, e vlerës, e seriozitetit, e llafit burrëror, që e njëjtte institucionin e minjënjohjes njerëzore dhe fjalën e tij nuk mund ta ktheje as ta neglizhojë. Një burrë me karakter fisnik, një oxhak me rrënjë labërishte, që punonte dhe vepronte me shokë dhe që të bënte për vete të impononte respect dhe fliste gjithmonë me mend në kokë, në kuvende dhe në tavolina, në takime dhe në rrugë, pot ë shkëmbeje ndonjë mendim.

Ai ishte tërësisht i predispozuar, i përkushtuar dhe ofronte kudo shpirtbardhësi dhe punë e përkushtim, kërkonte zgjidhje dhe ofronte zgjidhje. Nëse ka burra që u ngjiste llafi "si me zamkë" ishte i dukuri, i njëhsuar dhe i trupëzuar me problemet, i hapur dhe i drejtpërdrejtë, këmbëngulës deri në fund i papërtuar dhe nuk e pëlqente kurrë rehatinë dhe javashllëkun. Ishte njeri me kulturë të gjerë e të shumëanshme, ushtarak klasi me dije ekselente, që kudo ku punoi e jetoi ofroi nder, krenari, dinjitet dhe seriozitet të lartë, ku edhe miqtë, shokët e kolegët e prisnin, e donin dhe e respektonin mendjen plot arsytim të mikut të tyre Xhemil Çela. U largua nga jeta një lis Labërie, në përjetësi, ushtarak plot vlera, njeri i lindur talent, familjar i përkushtuar, njerëzor dhe i papërtuar, shok me vlera të vecanta, personalitet i rrallë njerëzor, profesor që spikati në përgatitjen e vlerave të ardhme shkencore, duke ridimensionuar produktivitetin e veprimtarive shoqërore e duke e kanalizuar gjithcka në interesin kombëtar. Ai ishte njohës i thellë i botës akademike shqiptare dhe punoi që vlerat e shqiptarizms të përjetësohen, të shkruhen në memoristikën duke kontribuar vetë në kulturën kombëtare të letrave.

Ky kontribut ishte pjesë esenciale e kontributeve shkencore të ushtarakëve në përjetësimin e memories historike të Forcave të Armatosura shqiptare. Ai donte dhe kërkonte duke motivuar e stimuluar futjen e të rinjve veçanërisht nga Labëria në rrugën e kërkimit shkencor, në procesin e doktoraturave dhe në shkrime e publikime që i kishte shumë për zemër. Në vitet 2000, kujtoj kur Xhemili punonte për librin "Familja dhe fisi Çela në shekuj" (1660-2000), kur çdo mbasdite në prag të publikimit të librit të tij, vinte në ambjentet e Akademisë Ushtarake "Skënderbej", kur në përgatitjen e tabelave të katërqind viteve të brezave të fisit të tij e mbështeste një student elitare, Arbër Zaimaj, njohës perfekt i programeve kompjuterike, kur punonin me orë të tëra bashkarisht për të përgatitur pemën gjenealogjike të fisit "Çela" të Gusmarit si rrallë libër në Labëri e më gjerë, duke i dhënë një dimension gjithë brezave e brezëve duke zbuluar thellësinë e shekujve dhe duke rezatuar një kulturë që Labëria dhe gjithë shqiptarët e meritojnë. Prandaj librat që krijoi mendja e tij ishin në avangardë, të thellë dhe të gjerë në mendim dhe që mund të merren për referencë për të djeshmen të sotmen dhe të nesërmen shqiptare.

Xhemil Çela ishte dhe mbeti një gur i rëndë i Labërisë, që lëshoi dritë dhe ndriçoi historinë e fisit, fshatit e krahinës si askush tjetër, ndriçoi me shkrimet e tij burra të shquar e të çmuar të shekujve, trima, e të mençur, që lartësoi simbolikën labe në dhjetra e qindra takime e kuvende, ku nderi e kërkonte fjalën e tij të mençur e plot arsytim. Ai ishte identifikuar si institucion labërie, si shkollë mendimi dhe mësues e arsytues që dinte të jepte drejtim e zgjidhje edhe çështjeve më të koklavitura dhe më të pështjelluara. Ai ishte një mal mendimi labërie

sepse e kishte zgjuarsinë natyrale të marrë në vendlindje dhe të kultivuar rrugëve e shtigjeve të jetës. Shkrimet e librat e tij janë brilante janë mendim, gdhendje magjepsëse e shpirtit fisnik të labit, një dhuratë për brezat, një gurrë medimi i pjekur dhe i rrahur në kudhrën e jetës. Në plotronin fisnik të mençurisë është gjithmonë një vend i rezervuar për veprën publicistike të Xhemil Çelës që brezat sot dhe në të ardhmen do t'i referohen. Ai nuk bën kompromis me të vërtetën, por i hap asaj rrugë sepse edhe e zhurmshme edhe e heshtur e vërteta është e kristaltë, që edhe pse mund të bezdisë dhe mund të prishë edhe ndonjë qetësi përsëri është e dashur sepse është e vërtetë. Çdokush që e ka lexuar është tretur në mendimin mjeshtëror të tregimit, logjikës dhe arsytimit të Xhemil Çelës. Ai nuk e përkëdhel dhe nuk i bie në qafë historisë, por e shpreh mendimin të pastër e të qelibartë, që të ketë shijë sot e mot e përgjithmonë.

Ai që prej tre dekadash ka punuar sikurse ka qenë shtetar që duhet të shkonte në zyrë përditë, ka qenë udhërrëfyes për brezat e rinj, i ka orientuar e udhëhequr edhe në fushën e kërkimit shkencor, të punimit në arkiva, të kërkimit në libra, falë edhe horizontit tepër të gjerë e të spikatur, avantazh që ja jepte edhe njohja e gjuhëve të huaja. Ai ishte dhe ngeli frymëzim deri në fund të jetës. Xhemil Çela e sillte fjalën të qeruar, me ndjenjë, gjithmonë të argumentuar, plot finesë dhe mendim. Jetonte me ndjenjat, mendimet, gëzimet e hidhërimet e njerëzve, trupëzohej me to, shkruante e lexonte, nuk duronte padrejtësitë, dhe syntonte të përcillte tek bashkëbiseduesit besim dhe ëmbëlsi fjale, kthjelltësi shpirti jetësor. Dinte të kritikonte, të motivonte, të stimulonte, të jepte udhë problemeve. Njerëzit thoshin se rrallë kemi parë lab të qetë e të shtruar si Xhemili, por ai hovet e zembrës i kishte përbrenda si prush mendimi, që edhe digjte edhe ngrohte por gjithmonë me shpirtbardhësi, njeri që nuk rendtete kurrë pas dekoratave, sepse ishte mbrujtur i thjeshtë dhe i pazëshëm përpara zhurmave. Ai krijoi një thesar të pavdekshëm krijimtarie që brezat do t'i jenë mirënjohës përjetësisht. Profesor Xhemil Çela, ishte dhe mbeti deri në fund të jetës së tij një shtetar i mirë, i cili ka menduar që gjeneratat e ardhshme të mësojnë të shkuarën sepse "pa të shkuar nuk ka të ardhme".

Nga ana tjetër Xhemil Çela gjithmonë e ka vërtetuar se ka qenë dhe ka ngelur deri në fund të jetës një ushtarak fisnik, një burrë shteti i talentuar, një lab me rrënjë me veti e cilësi të spikatura që e donte fort vendin e tij dhe që e shpaloste atdhedashurinë e përgjegjshmërinë e njeriut, shqiptarit, labit që e donte me zemër të ardhmen dhe mbron të drejtën në kufijtë e qënies kombëtare edhe si funksionari i shoqërisë, shtetit e kombit kërkonte që t'ju lërë brezave atë që shpesh ka munguar: "të vërtetën, të drejtën, të ndershmen, intelektualizmin ushtarak". Xhemil Çeli shpresonte shumë se do të kalonte kjo flamë virusale ndaj edhe u drejtohej bashkëfshatarëve të vet të Gusmarit natën e vitit të ri 2021: "Të dashur bashkëfshatarë Gusmariot kudo që ndodheni! Në këtë prag Viti të Ri 2021 lutem pranoni, pas një viti të vështirë e të dhimbshëm, urimet e mia më të përzemërta për vitin e Ri ta kaloni plotë shëndet, gëzime e lumturi familjarisht! Xhemil Çeli". Por nuk ishte e thënë, edhe pse ai një copëz të zembrës e kishte lënë atje në Guzmariot e tij të dashur, në Kurvelesh dhe në Labëri. Ai nuk kishte se si ta dinte që do të ishte urimi i fundit për dufet e zembrës së tij, sepse parajsa e donte për në përjetësi, lart përmbi re në malet e Labërisë. Nderim dhe homazhi për Xhemil Çelën e Gusmarit dhe të mbarë Labërisë që shkoi në përjetësi!



## MODERNIZIMI I FA

# Ushtria Amerikane dhuron 29 mjete “Humvee” për Forcat e Armatosura

Ambasada Amerikane në Tiranë: “Këto automjete janë dhurim për Forcat e Armatosura të Shqipërisë nga Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe do të ndihmojnë në rritjen e gatishmërisë ushtarake shqiptare dhe ndërveprimit të saj me NATO-n”. 25 shkurt 2021.

